



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE
UJËSJELLËS KANALIZIME LUSHNJE SH.A**

Nr. _____ Prot.

Date

**PROCES VERBAL - Tipi i kontratës – PUNË
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky proces verbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: Furnizimi me ujë për zonat bregdetare të Bashkisë Divjake dhe Nj.A.Remas,Loti II

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj; 18 Muaj

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- (CPV): 45000000-7 – Punë ndërtimi
- (CPV): 45232430-5 - Punime për trajtimin e ujit

VLERA E FONDIT LIMIT: 798,376,733 (shtatëqind e nentëdhjetë e tete milion e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e tridhjetë e tre) lek pa tvsh, Ose 8,495,176.98 (tete milion e katerqind e nentëdhjetë pese mijë e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë pike nentëdhjetë e tete) euro

Burimi i financimit: vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit.

Autoriteti kontraktor në kriteret e përgjedhjes së fituesit ka përgjedhur si më poshtë:

A) Oferta ekonomike më e favorshme, bazuar në kosto X

Sipas rëndësisë:

Çmimi □	pikët 50
Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit □ □	pikët 20
Stafi / Organizimi i Kompanise □ □	pikët 15
Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social □ □	pikët 10
Periudha e garancisë së objektit □ □	pikët 5

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Metodologjia e vlerësimit për Ofertën ekonomikisht më të favorshme bazuar në kosto

Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100. Autoriteti kontraktor do të vlerësojë pikët për kriteret me vlerësim relativ (kriteri 1, 2.a, 5) e rrumbullakosur me dy shifra pas presjes dhjetore (0,00) ndërsa për kriteret me vlerësim absolut (kriteri 2.b , 3, 4) do të vlerësohen me numra të plotë (0).

Kriteri:

1. Çmimi [50] pikë

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

P_{k1} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\min k1}$ Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k1}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

2. Grafiku i punimeve dhe koha e mobilizimit [20 pikë]

Operatori ekonomik mund të propozojë duke paraqitur një grafik të detajuar që argumenton kohën e propozuar për përfundimin e punimeve të kontratës. Operatori duhet të argumentojë (në mënyrë përshkrimore dhe grafike) kohën e propozuar (**jo më shumë se 18 muaj**). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nënkriteri:

a. Koha e realizimit të punimeve të kontratës që përfshin: [15 pikë]

I Kohën e mobilizimit në kantier (jo me shume se 3 muaj) [2 pike].

II Grafiku i punimeve te Kontratës. [13 Pike]

*Shënim: Operatori ekonomik për të justifikuar propozimin e këtij nënkriteri duhet të paraqesë minimalisht analizen e makinerive që do angazhojë operatori ekonomik për secilin proces dhe numrin e përafërt të punonjësve të angazhuar për çdo proces.

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k2a} = V_{\min k2a} \times P_{\max k2a} / O_{k2a}$$

P_{k2a} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\min k2a}$ Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k2a}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k2a} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

- b. Faktorë favorizues / pajisje inovative / metodologji punimesh që favorizojnë kohën e realizimit të punimeve [0-5 pikë]

3. Staf / Organizimi i kompanisë [15 pikë]

Operatori ekonomik duhet të tregojë se do të angazhojë në kontratë staf me eksperiencë të mjaftueshme për të realizuar me sukses objektin e prokurimit. Për të treguar këtë fakt operatori duhet të depozitojë për secilin nga stafi kryesor dokumentacionin e kërkuar në seksionin 2.3 / Kriteret e veçanta të kualifikimit. Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

- a. Formimi akademik i stafit kyç dhe eksperiencia në fushen specifike [13 pikë]

*Shënim: Vlerësimi i këtij nënkriteri do të realizohet sipas përcaktimeve më poshte:

I. Dëshmi që stafi plotëson vetëm kushtet e kritereve të veçanta të kualifikimit për stafin [1 pikë]

II. Dëshmi që stafi disponon kualifikime akademike mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit për stafin [3 pikë]

III. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në vite pune mbi nivelin minimal të kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit për stafin [3 pikë]

IV. Dëshmi që stafi disponon eksperiencë në natyrë/kompleksitet të ngjashme me kontratën e prokurimit. [6 pikë]

Për përmbushjen e kritereve të mësipërme duhet të dorëzohet CV dhe dëshmi/reference/dokumentacion të leshuar nga punëdhënes të mëparshëm ose përfituesit.

- b. Skema e organizimit të stafit e propozuar për realizimin e kontratës objekt prokurimi [0 - 2 pikë]

*Shenim: Per permbushjen e kriterit te mesiperm operatori ekonomik duhet te dorezoje organigramen e propozuar te stafit qe do te operoje ne ekzekutimin e kontrates, metodologjise te nderveprimit midis strukturave me njera-tjetren, me mbikeqyresin e punimeve dhe Autoritetin Kontraktor/Entin. Avantazh perbejne sistemet e brendshme te kontrollit dhe menaxhimit te cilesise.

4. Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social [0-10 pikë]

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një metodologji të qartë për minimizimin e ndikimit në mjedis të veprës si dhe propozimet e tij për menaxhimin e riskut mjedisor dhe social (sipas Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

- a. Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin) / të ricikluara / efçente / materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike. Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore. [0-5 pikë]
- b. Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zones ku zhvillohet projekti si një iniciative sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve. [0-5 pikë]

5. Periudha e garancisë së objektit [0 – 5 pikë]

Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm:

Periudha e garancisë e punimeve civile / pajisjeve (jo më pak se 2 vjet) [0 - 5 pikë]

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k5} = V_{\min k5} \times P_{\max k5} / O_{k5}$$

P_{k5} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\min k5}$ Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k5}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k5} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Argumentim:

Autoritetet Ose entet kontraktore përcaktojnë dhënien e kontratave publike bazuar në oferten ekonomikisht më të favorshme.

Oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në barze çmimit ose kotos, duke përdorur metodën e efektivitetit të koston, siç janë koston gjatë ciklit jetësor, ne përputhje me nenin 88 të këtij ligji, dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilesi, që vlerësohet mbi bazën e

kritereve që lidhen me objektin e kontratës procedurë prokurimi, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.

Kritere të tilla mund të përfshihen:

a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij;

b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; ose

c) shërbimin pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet dorëzimit, si, për shembull, datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit, Elementi i kostos, gjithashtu, mund të marrë formën e një çmimi ose kostoje fikse, mbi bazën e cilit operatorët ekonomikë do të konkurrojnë vetëm për kriteret e cilësisë.

3. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:

a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve, ose

b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë substancës së tyre thelbësore.

5, Autoriteti ose enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i i, çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të raste kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.

Njësia e Prokurimit hartoj kërkesën për Grafikon e punimeve dhe kohën e mobilizimit dhe ka kërkuar këto kriter 20 pikë, duke vlerësuar rëndësinë që ka ky element në përfundimin e plotë dhe realizimin suksess të çdo veprë, pasi duke ndërthurur elementin cilësi, saktësi dhe precizion në kryerjen e punimeve por edhe angazhimin realisht të të gjithë stafit, inxhinierë, teknikë, specialistë, punëtorë të thjeshtë etj, mund të arrihet që punimet të kryhen edhe më shpejt se koha e planifikuar nga autoriteti kontraktor dhe njëherësh me cilësinë e duhur, duke i dhënë besimin këtij autoriteti për angazhimin serioz dhe të operatorit ekonomik pjesëmarrës cili në përfundim do të sjellë rezultatet e kërkuara dhe të pritura nga autoriteti.

Operatori Ekonomik mund të propozojë duke paragjitur një grafik të detajuar që argumenton kohën e propozuar për përfundimin e punimeve të kontratës. Operatori Ekonomik ofertues duhet të argumentojë në mënyrë përshkimore kohën e propozuar të kryerjes së punimeve.

Po kështu një rëndësi e vecantë nga autoriteti kontraktor i jepet edhe elementit Staf/ Organizimi Kompanise, i cili vlerësohet deri në 15 pike, duke ditur që vetëm një staf kualifikuar profesional inxhiniero - teknik dhe me përvojën e duhur mund të sjellë rezultatet e dëshiruara dhe të pritura nga autoriteti, kontraktor për përfundimin me sukses të objektit të prokurimit. Një operator ekonomik cili ka një staf të tillë mund të konkurrojë me cilësi pranë autoritetit kontraktor dhe të përmbushë të gjithë detyrat e projekt preventivit të parashikuar nga autoriteti kontraktor. Operatori Ekonomik ofertues duhet të deshmojë se do të angazhojë në kontratë një staf me përvojë eksperiencë të mjaftueshme për të realizuar me sukses objektin e prokurimit.

Disa nga nënkriteret janë formimi akademik i stafit kyç dhe eksperiencia në fushën specifike të cili provohet me dokumentacionin përkatës Gjithashtu operatori ekonomik duhet të paragesë edhe skemën e organizimit të stafit të propozuar për realizimin e kontratës, organigramën e propozuar të stafit që do të operojë në ekzekutimin e kontratës, metodologjinë e ndërveprimit midis strukturave me njëra-tjetrën, me mbikqyrësin e punimeve dhe Autoritetin Kontraktor etj.

Në lidhje me Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social, autoriteti kontraktor ka kërkuar deri në 10 pikë, duke ditur rëndësinë që ka mjedisi aktualisht dhe fakti që në veprimet apo mosveprimet tona ndikojnë në mjedis dhe në komunitetin tonë të përbashkët pozitivisht/ negativisht

Duke patur parasysh se përveç realizimit të veprës duhet që të aplikohet nga operatorët realizues të punimeve edhe parandalimi, minimizimi dhe mënjanimi i ndikimeve negative ndaj mjedisit. Duke ditur që nga punimet që do të kryhen gjatë ndërtimit të një vepre mund të krijohen mbetje inerte, detyrat kryesore që do të ketë parasysh operatori ekonomik janë ndër të tjera edhe kontrolli i vazhdueshëm i gjendjes së mjedisit në territorin ku do të zhvillohet aktiviteti, mbajtja pastër e gjithë territorit ku kryhet veprimtaria, respektimi dhe zbatimi i të gjitha masave për të eliminuar ndikimin në mjedis, flore dhe faune, respektimi dhe zbatimi i të gjitha masave për të eliminuar ndikimin në popullsi, shëndetin human, respektimi dhe zbatimi i të gjitha masave për të eliminuar ndikimin në klimë, ajër, ujë, tokë etj. Në veçanti duhet të kushtojë rëndësi edhe faktorëve: Respektimi i procedurave, normave, standarteve dhe planifikimet e paragitura në projekt gjatë realizimit të tij si dhe të kontrollojnë vazhdimisht ecurinë e treguesve mjedisorë.

Për të gjitha këto elementë operatori ekonomik pjesëmarrës bën një pasqyrë të qartë dhe të detajuar që në momentin kur ai konkuron në procedurën e prokurimit duke dhënë Propozime konkrete se si do të ndikojë në uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social, dhe më pas autoriteti kontraktor bën vlerësimin real me pikëzim të cdo operatori ekonomik ofertues.

Nënkriteret për operatorët ekonomike pjesëmarrës në këtë rast dhe që do të vlerësohen në mënyrë të pikëzuar nga Komisioni Vlerësimit të Ofertave të Autoritetit Kontraktor, do të jenë:

Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (migësore me miedisin të ricikluara/ eficientë/materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike, Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zonës ku zhvillohet projekti si një iniciativë sociale e ofertuesit nëpërmjet punësimeve.

Një rëndësi e veçantë i është dhënë edhe Periudhës së garancisë së objektit të cilën tregon jetegjatësinë e objektit, faktin se sa më maksimale të jetë periudha aë përfshin garancinë e vepres e deklaruar nga operatori ekonomik pjesëmarrës, aq më tepër autoriteti kontraktor bindet për angazhimin, seriozitetin dhe kapacitetin e këtij operatori ekonomik, me qëllimin final realizimin përfundimtar të vepres dhe marrjen në dorëzim të saj.

Gjithashtu, në bazë të Nenit 21 pika 2 të Ligjit N.162 / 2020 Për Prokurimin Publik, të ndryshuar, Nenit 2, pika 2/c dhe Nenit 78, pika 2 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, njësisë e prokurimit pranë Autoritetit Kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës – Kanalizimeve, Lushnjë Sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin

dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar.

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas përcaktimeve në Kriteret e Përgjithshme të Perzgjedhjes / Kualifikimit pika 1 e Shtojcës 7

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në kërkesat e pikes 1, Shtojca 7

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit **2023, 2024, 2025** të konfirmuara me vulë pranë administratës tatimore. Operatorët Ekonomikë të cilët plotësojnë 2 nga 3 kërkesat e germës “c” të nenit 41 të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar; krahas bilanceve të paraqesin dhe raportet e audituesit të pavarur (Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar) për bilancet e këtyre viteve të konfirmuara nga administrata tatimore.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

2.2.2. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit **2023, 2024, 2025** lëshuar nga Administrata Tatimore, ku xhiro mesatare e këtyre tre viteve të jetë me vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.2.3. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vertetim nga organet e pushtetit lokal (Komuna / Bashkia) për shlyerjen e taksave vendore ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar **(të vitit 2026)** sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia ose Komuna në të cilën është regjistruar sipas QKB-se.

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 pika 1/b dhe 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: b) **gjendjen ekonomike dhe financiare;** ...3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko financiare” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, **paragrafi 1 dhe 2 germa “b”**, parashikohet: Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare¹. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Përcaktimi i viteve të

kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht: Ligjit Nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29 i tij i cili percakton: “Çdo tatimpagues përgatit **deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme** në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, **duke paraqitur në të njejtën kohë bilancin kontabël**, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji; Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5 datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Pika 3.12 e tij, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25 date 10.05.2018 “Per Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni9 ku parashikohet: “Kohëzgjatja e periudhës raportuese është 12 muaj. Periudha raportuese fillon në datën 1 janar dhe përfundon në datën 31 dhjetor. Përjashtimet për veprimtaritë e veçanta, me propozimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, miratohen nga ministri përgjegjës për financat”; Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”. Ne keto kushte, vleresojme të kërkojme kete dokumentacion pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës** bilancin kontabël së bashku me anekset e tij si dhe akt ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

Njësia e prokurimit kerkoi edhe **pagesat e taksave vendore** bazuar në Ligjin Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”(te ndryshuar), neni 5, pika c, sipas afateve te miratuara te kryerjes se pagesave te percaktuara nga çdo njesi e qeverisjes vendore si dhe faktit se në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë rregjistrin tregtar dhe për qëllim të rregjistrimit fiskal, ku përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qenë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet qe ushtrojne aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likujduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ose

- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

**Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.
Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomike do të kryhet bazuar në dokumentacionin e mëposhtem:**

Ne rast se punimet janë kryer me ente publike:

Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, duhet të paraqesë Kontratën e Sipërmarrjes; formular vlerësimi leshuar nga Investitori sipas Shtojcës 9; situacion perfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve; Faturat Tatimore të deklaruara në organet tatimore; Aktin e Kolaudimi; dhe Certifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përhershëm .

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

Ne rast se punimet janë kryer me sektorin privat:

Operatori Ekonomik, si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë vertetime të shoqëruara me fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore dhe situacion perfundimtar për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Pika 2.3.1 gërma “a” plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Kurse pika 2.3.1 gërma “b” duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. (Neni 88, pika 3, i VKM-se Nr.285 date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar).

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 4 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” ku përcaktohet se: “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë

burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën”

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.** Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”

Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret për punë të ngjashme si më lart duke qenë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura me objektin e kontratës. Përvojat e mëparshme janë element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin se operatorët ekonomikë zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Kriteri i kapacitetit teknik siguron se operatorët ekonomikë që marrin pjesë në procedure kanë përvojën dhe ekspertizën e nevojshme për të kryer punën me cilësi të lartë. Përdorimi i operatorëve me përvojë të mëparshme siguron që puna do të kryhet me sukses dhe pa ndërprerje. Përvoja e mëparshme në projekte të ngjashme siguron që operatorët janë të gatshëm për situata të papritura dhe janë në gjendje të menaxhojnë situatat e mundshme në mënyrën e duhur. Kriteri i kapacitetit teknik ndihmon në sigurimin e një konkurrence të ndershme dhe të përshtatshme në procedure.

Referuar këtij neni, njësia e prokurimit vlerëson se duhen kërkuar disa prej dokumentave ligjore të zbatimit të punimeve, bazuar në Ligjin Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit”(i ndryshuar), si dhe akteve dhe VKM të dala në zbatim të tij, pasi duke qenë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës krahas dokumentacionit të përcaktuar në nenin 39 pika 5/a dhe b, të paraqesin dhe situacionet përfundimtare si dhe formular vlerësimi për punët e kryera me entet publike. Kjo bëhet me qëllim që autoriteti kontraktor të bindet nëse operatori ekonomik zotëron përvojën e nevojshme për zbatimin e kontratës, ku punimet e mëparshme duhet të kenë zëra të konsiderueshme punimesh me zërat e punimeve që po prokurohen, si dhe në rastin kur punimet e mëparshme janë kryer si bashkim operatorësh ekonomikë, nuk jepet informacion mbi përqindjen e anëtarëve në bashkim, në vërtetimet që lëshojnë autoritetet

kontraktore dhe në faturat tatimore të shitjes, ku këto të fundit lëshohen nga përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Meqënëse paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, nuk sjell diskriminim dhe/ose kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, por i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e përvojës së duhur të tyre, duke mundësuar zhvillimin normal dhe në kohë të procedurës së prokurimit, pasi nuk ka nevojë që Autoriteti të kërkojë informacione shtesë gjatë vlerësimit të ofertave (në rast mungese të informacionit të sipërcituar), njësia e prokurimit gjykon se kërkimi i dokumentacionit të përcaktuar në kushtin e mësipërm është i nevojshëm për vërtetimin e kryerjes së punëve të ngjashme.

Gjithashtu është kërkuar në DST:

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontraten e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, është kërkuar edhe paraqitja e kontratës së bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE, sipas parashikimeve të nenit 88 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij dokumentacioni autoriteti kontraktor ka mundësi të njihet me vlerën reale të punimeve të realizuara nga ofertuesi/t, mbi bazën e një kontrate të realizuar si BOE.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor është kërkuar edhe miratimi nga ana e autoritetit kontraktor, si nënkontraktor i deklaruar, në respektim të parashikimeve të nenit 89 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Dokumentacioni i kërkuar si më sipër, është kërkuar me qëllim që Autoriteti Kontraktor të përlllogarisë vlerën e saktë të kontratave të mëparshme të realizuara nga ofertuesi, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2.3.1.

2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës

- a) Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se disponon liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë kriter, duhet të paraqesë liçensën përkatëse të shoqërise, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për Miratimin e Rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve Juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë profesionale të shoqërisë, të vlefshme, për kategoritë e mëposhtme:

- | | | |
|--------------------------|---|----------------------|
| • Kategoria NP- 1 | Punime gjurmimi në tokë | Klasifikimi C |
| • Kategoria NP- 4 | Rruge, autostrada, ura, mbikalime... | Klasifikimi A |
| • Kategoria NP- 7 | Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje | Klasifikimi F |
| • Kategoria NP-12 | Punime të inxhinierisë së mjedisit | Klasifikimi A |
| • Kategoria NS-18 | Punime topogjeodezike | Klasifikimi B |
| • Kategoria NS-20 | Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë | Klasifikimi A |

Në rastet e mbështetjes në kapacitete të subjekteve të tjera / Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, secili anëtar i bashkimit duhet t'i disponojë në raport me zërat, përqindjen e marrë përsipër, sipas angazhimit me shkrim / kontratën e bashkëpunimit.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin / njehsimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht s'kualifikues.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:**aftësinë teknike dhe profesionale**;...Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë **se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”.

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” përcaktohet “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:a) **licenca profesionale** të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;”

VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 të ndryshuar “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” (lidhja 2, 3 dhe 4). Referuar zërave të punimeve që përmban preventivi i punimeve objekt kontrate, në mbështetje të Ligjit Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” (të ndryshuar), si dhe në zbatim të VKM Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë

veprimtari ndërtimi”, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë në licencën profesionale për zbatimin e punimeve, kategoritë e kërkuara të përcaktuara sipas llojit dhe nënlllojit të objektit të punimeve, si dhe klasifikimin në nivelet e kërkuara për çdo kategori punimesh, kërkesa të cilat kanë lidhje dhe janë proporcionale me objektin e kontratës. Llojet e licencave dhe niveli i klasifikimit të tyre, sipas kategorive dhe niveleve (gërmave) përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlogaritur sipas preventivit të hartuar për këtë objekt. Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategoritë respektive është kërkuar bazuar në zërat e punimeve që parashikohen të kryhen dhe që përfshihen në kategorinë përkatëse brenda vlerave të kufijve të parashikuara në VKM Nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar.

Sipas VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 të ndryshuar, përcaktohet:

Kategoria N.P - 1 “Punime gërmimi në tokë” Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Referuar nenit 77 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 39 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, si dhe VKM Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit”, kërkesa për disponimin e licencës N.P-1 “Punime Gërmimi në Tokë” është e lidhur ngushtë me natyrën, kompleksitetin dhe volumin e punimeve objekt kontrate.

Sipas përcaktimeve të VKM Nr.42/2008, në kategorinë **N.P-1** përfshihen punimet e gërmimit, sistemimit dhe ndryshimit në volum të tokës, hapja e kanaleve, gërmimet për themele dhe struktura, transporti i materialeve të dala nga gërmimi, si dhe mbushjet e ngjeshjet e nevojshme për realizimin e veprave inxhinierike.

Objekti “Furnizim me ujë për zonat bregdetare të Bashkisë Divjakë dhe Njësisë Administrative Remas” parashikon realizimin e infrastrukturës së furnizimit me ujë, ndërtimin e objekteve hidroteknike dhe strukturave mbështetëse, punime të cilat kërkojnë në mënyrë të domosdoshme kryerjen e proceseve të gërmimit dhe sistemimit të terrenit.

Konkretisht në preventiv janë parashikuar zërat:Gërmim dheu me ekskavator zinxhir 0.5 m³, në kanale me gjerësi > 2 m, tokë kategoria IV, me shkarkim në mjet”, në sasi 60 m³; Gërmim dheu me ekskavator zinxhir 0.5 m³, në kanale me gjerësi > 2 m, tokë kategoria IV, me shkarkim në mjet”, në sasi 5 m³;Transport dheu me auto deri 2.0 km”, në sasi 65 m³; Gërmim dheu me ekskavator zinxhir 0.5 m³, në kanale me gjerësi > 2 m, tokë kategoria IV, me shkarkim në mjet”, në sasi 150 m³; Mbushje, rafshim dhe ngjeshje me tokmak elektrik çdo 30 cm”, në sasi 4 m³; Gërmim dheu themele e plinta me b ≤ 2 m, ekskavator me zinxhir 0.5 m³, shkarkimi në auto”, në sasi 20 m³.

Përveç zërave të mësipërm, vetë natyra e investimit, e cila përfshin ndërtimin e godinave teknologjike, puseta, rezervuarëve, vendosjen e tubacioneve të transmetimit dhe shpërndarjes së

ujit, kërkon realizimin e vazhdueshëm të gërmimeve lineare dhe gërmimeve për struktura gjatë gjithë gjatësisë së rrjetit.

Gjithashtu, projekti zhvillohet në zonën bregdetare të Bashkisë Divjakë, ku kushtet gjeologjike dhe prania e ujërave nëntokësore kërkojnë përdorimin e teknikave të specializuara të gërmimit dhe stabilizimit të terrenit, me qëllim garantimin e sigurisë së punimeve dhe mbrojtjen e infrastrukturës që do të ndërtohet.

Për sa më sipër, njësia e prokurimit vlerëson se kërkesa për licencën **N.P-1** është e lidhur drejtpërdrejt me zërat e preventivit, është proporcionale me natyrën dhe kompleksitetin e kontratës dhe garanton që operatorët ekonomikë pjesëmarrës disponojnë kapacitetet profesionale dhe teknike të nevojshme për realizimin e suksesshëm të punimeve objekt prokurimi.

Kategoria N.P – 4 “Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tranvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale. Referuar nenit 77 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 39 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe VKM Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit”, kërkesa për disponimin e licencës N.P-4 “Rrugë, Autostrada, Mbikalime, Hekurudha, Tramvaj, Metro, Pistat e Aeroporteve” është e lidhur drejtpërdrejt me zërat e preventivit dhe me punimet e rikonstruksionit të sipërfaqeve rrugore që preken nga realizimi i rrjetit të ujësjellësit.

Sipas përcaktimeve të VKM Nr.42/2008, në kategorinë N.P-4 përfshihen ndërtimi, rikonstruksioni, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve, si dhe realizimi i shtresave rrugore, nënshtresave, shtresave mbajtëse dhe elementëve të tjerë të infrastrukturës rrugore.

Objekti “Furnizim me ujë për zonat bregdetare të Bashkisë Divjakë dhe Njesisë Administrative Remas” parashikon ndërhyrje në infrastrukturën ekzistuese rrugore për realizimin e rrjetit të furnizimit me ujë, duke kërkuar më pas rikthimin e sipërfaqeve në gjendjen e tyre funksionale dhe teknike sipas standardeve të ndërtimit.

Nga analiza e preventivit rezulton se janë parashikuar konkretisht zëra të tillë si: Shtresë çakëlli mbeturinë kave t = 15 cm, e përhapur dhe e ngjeshur me makineri”, në sasi 75 m²; Ndërtim kasonete në tokë mesatare”, në sasi 20 m²; Shtresë çakëlli mbeturinë kave t = 20 cm, e përhapur dhe e ngjeshur me makineri”, në sasi 50 m²; Nënshtrësë zhavori”, në sasi 3.6 m³; Trotuar me beton 6 cm dhe pllaka”, në sasi 20 m².

Këta zëra përfaqësojnë punime tipike të infrastrukturës rrugore dhe lidhen drejtpërdrejt me rikonstruksionin e sipërfaqeve të prekura nga gërmimet për vendosjen e tubacioneve të ujësjellësit, ndërtimin e pusetave, nyjeve hidraulike dhe objekteve të tjera të projektit.

Gjithashtu, realizimi i shtresave të çakëllit, nënshtresave mbajtëse dhe elementëve të tjerë rrugorë kërkon përdorimin e makinerive të specializuara, metodologjive teknike dhe personelit të kualifikuar që mbulohen nga licenca N.P-4.

Kërkesa për këtë kategori licence synon të garantojë që operatori ekonomik disponon kapacitetin teknik dhe profesional për të realizuar jo vetëm punimet e furnizimit me ujë, por edhe rikthimin e plotë të infrastrukturës rrugore të prekur gjatë zbatimit të kontratës, duke respektuar standardet teknike të ndërtimit dhe sigurinë e përdoruesve të rrugës.

Kategoria N.P-7 “Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje” Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose rristurime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin “e shërbimit hidrik kompleks” ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta si edhe në të gjitha impiantet mekanik të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal. Kërkesa për disponimin e licencës profesionale të shoqërisë në kategorinë **NP-7 Ujësjiellës, Gazsjiellës, Vajsjiellës, Vepra Kullimi e Vaditje, Klasa F**, mbështetet në nenin 77 pika 1/a dhe pika 4 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe në nenin 39 pika 6 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë licenca profesionale të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate.

Gjithashtu, referuar VKM Nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, kategoria **NP-7** përfshin ndërtimin, rikonstruktionin dhe mirëmbajtjen e ujësjiellësve, stacioneve të pompimit, rezervuarëve të ujit, rrjeteve shpërndarëse, tubacioneve, rakorderive, veprave hidraulike dhe të gjitha impianteve ndihmëse të nevojshme për funksionimin e sistemit të furnizimit me ujë.

Kjo kategori licence është kërkuar pasi përbën kategorinë kryesore të punimeve që parashikohen në preventivin e objektit “Furnizim me ujë për zonat bregdetare të Bashkisë Divjakë dhe Njësisë Administrative Remas”.

Konkretisht, në preventiv janë parashikuar zëra të tillë si: Furnizim dhe vendosje tubash PEHD të dimensioneve të ndryshme; Furnizim dhe montim rakorderish PEHD; Furnizim dhe montim saraçineskash; Furnizim dhe montim ajruesish; Furnizim dhe montim valvulash shkarkimi; Ndërtim pusetash kontrolli; Ndërtim pusetash komandimi; Ndërtim rezervuari furnizimi me ujë me kapacitet 1500 m³; Lidhje familjare të abonentëve; Punime hidromekanike të sistemit të furnizimit me ujë; Punime të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së ujit.

Nga analiza e preventivit rezulton se pjesa dërrmuese e fondit limit është e lidhur drejtpërdrejt me punime të kategorisë NP-7, pasi objekti konsiston në ndërtimin e një sistemi të plotë furnizimi me ujë, duke përfshirë linjat kryesore të transmetimit, rrjetin shpërndarës, rezervuarët, pusetat dhe pajisjet hidraulike.

Klasifikimi F është përcaktuar në përputhje me vlerën e punimeve që përfshihen në këtë kategori, sipas kufijve të përcaktuar në VKM Nr.42 datë 16.01.2008, pasi vlera e punimeve të rrjetit ujësjiellës, rezervuarëve dhe elementëve hidraulikë përbën pjesën më të madhe të investimit.

Për sa më sipër, njësia e prokurimit vlerëson se kërkitimi i licencës **NP-7 Klasa F** është në përputhje me natyrën, vlerën dhe kompleksitetin e kontratës, lidhet drejtpërdrejt me zërat e preventivit dhe nuk krijon kufizim të pajustificuar të konkurrencës, por garanton që operatorët ekonomikë

pjesëmarrës disponojnë kapacitetet teknike dhe profesionale të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës

Kategoria NP-12 “Punime të inxhinierisë mjedisore” Kërkesa për disponimin e licencës NP-12 “Punime të Inxhinierisë Mjedisore” mbështetet në nenin 77 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenin 39 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, pasi lidhet drejtpërdrejt me natyrën dhe vendndodhjen e punimeve objekt kontrate: “Furnizim me ujë për zonat bregdetare të Bashkisë Divjakë dhe Njesisë Administrative Remas” zhvillohet në një territor me ndjeshmëri të lartë mjedisore. Kjo zonë përmban laguna, habitate ujore, pyje bregdetare, dunat ranore dhe specie të mbrojtura me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare. Bazuar në zërat e preventivit rezultojnë se punimet përfshijnë gërmime lineare për vendosjen e tubacioneve, ndërtimin e rezervuarëve, puseta, godinave teknologjike, transportin e materialeve të gërmimit, mbushje dhe sistemime terreni, punime të cilat krijojnë ndërhyrje të drejtpërdrejta në mjedis dhe kërkojnë zbatimin e masave mbrojtëse gjatë gjithë periudhës së realizimit të kontratës.

Objekti përfshin gjithashtu ndërtimin e rezervuarit të ujit, puseta teknologjike, godinave të puseve, linjave të transmetimit dhe rrjetit shpërndarës, të cilat zhvillohen në zona me ndjeshmëri të lartë mjedisore dhe me pranimë të ujërave nëntokësore, duke kërkuar zbatim të masave mbrojtëse për ruajtjen e mjedisit dhe kontrollin e ndikimeve gjatë fazës së ndërtimit.

Kërkesa për këtë licencë synon të garantojë se operatori ekonomik disponon kapacitetet profesionale dhe teknike për menaxhimin e ndikimeve mjedisore që lidhen me zbatimin e punimeve, rehabilitimin e zonave të prekura nga ndërtimi, administrimin e materialeve të gërmimit dhe respektimin e kërkesave të legjislacionit mjedisor gjatë realizimit të kontratës.

Për shkak të pozicionimit të investimit në një zonë të mbrojtur mjedisore, zbatuesi i punimeve duhet të disponojë kapacitete profesionale për administrimin e ndikimeve mjedisore, rehabilitimin e sipërfaqeve të prekura, menaxhimin e materialeve të dala nga gërmimi, mbrojtjen e habitateve natyrore dhe respektimin e kushteve të përcaktuara në aktet mjedisore dhe lejet përkatëse.

Për rrjedhojë, licenca NP-12 nuk kërkohet vetëm për shkak të natyrës së punimeve, por edhe për shkak të vendndodhjes së investimit në një zonë të mbrojtur me ndjeshmëri të lartë ekologjike, ku realizimi i punimeve duhet të garantojë minimizimin e ndikimeve në mjedis dhe ruajtjen e vlerave natyrore të territorit. Për këtë arsye kërkesa konsiderohet e lidhur ngushtë me objektin e kontratës, proporcionale dhe e nevojshme për realizimin e saj.

Kategoria NS-18 “Punime topogjeodezike” Kjo kategori licence përfshin në mënyrë të thjeshtuar zbatimin e rërvimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike etj.

Eshtë kërkuar kjo kategori licence në përputhje me punimet që do të realizohen gjatë fazës së zbatimit duke u orientuar me kuotat, saktësinë e gjurmës së linjave, volumnin e gërmimeve etj, bazuar në projekt preventivin e punimeve. Gjithashtu, sipas parashikimeve në specifikimet teknike dhe raportin topografik të publikuar, del e domosdoshme për piketimet e kanaleve që do të gërmohen, ndërtimin e depove, sistemimet e volumeve të dherave dhe azhurnimet topografike të cilat shtrihen në të gjithë nënobjektet e preventivit.

Nga analiza e preventivit rezulton se janë parashikuar punime për ndërtimin e pusetave të shkarkimit, vendosjen e tubacioneve HDPE, montimin e elementëve hidraulikë, ndërtimin e objekteve civile dhe realizimin e strukturave të betonit e betonarmesë, të cilat kërkojnë paraprakisht dhe gjatë zbatimit kryerjen e proceseve të rilevimit topografik, piketimit, azhurnimit dhe kontrollit gjeodezik. Konkretisht në preventiv janë ka zëra punimesh për tubacione HDPE, puseta shkarkimi, elementë të rrjetit hidraulik dhe struktura civile që kërkojnë përcaktim të saktë të kordinatave dhe kuotave të zbatimit.

Gjithashtu, realizimi i rrjetit të ujës-jellësit kërkon kontroll të vazhdueshëm të kuotave të projektit, verifikim të pjerrësive të linjave, pozicionim të saktë të pusetave dhe strukturave teknologjike, si dhe hartimin e dokumentacionit pas përfundimit të punimeve, procese të cilat realizohen vetëm nga subjekte që disponojnë kapacitetet profesionale në fushën topogjeodezike.

Kategoria N.S - 20 Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë: Përfshihen shpimet për të vlerësuar gjeologjinë për ndërtimin e objektit inxhinierik. Shpimet për ujë dhe puse.

Referuar nenit 77 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 39 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe VKM Nr.42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, kërkesa për disponimin e licencës N.S-20 “Shpime Gjeologo-Inxhinierike, Puse e Shpime për Ujë” është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën e punimeve të parashikuara në objektin **“Furnizim me Ujë për Zonat Bregdetare të Bashkisë Divjakë dhe Njësisë Administrative Remas”**.

Sipas përcaktimeve të VKM Nr.42/2008, kategoria N.S-20 përfshin punime që lidhen me shpimet për ujë, ndërtimin, rehabilitimin, mirëmbajtjen dhe vënien në funksion të puseve, si dhe ndërhyrjet teknike në sistemet e shfrytëzimit të ujërave nëntokësore.

Bazuar në zërat e preventivit rezulton se projekti përfshin punime dhe pajisje që lidhen drejtpërdrejt me funksionimin e puseve të furnizimit me ujë, konkretisht: Furnizim dhe vendosje e koshit të thithjes (suction strainer) DN300, element i domosdoshëm i sistemit të marrjes së ujit nga pusi; Furnizim dhe montim i tubacioneve me fllanxha DN250 dhe DN50 që shërbejnë për lidhjen e sistemit të nxjerrjes së ujit me rrjetin transmetues; Furnizim dhe montim i saraçineskave DN300 dhe DN50; Furnizim dhe montim i valvulave moskthimi DN50; Furnizim dhe montim i nyjeve çmontuese, reduktorëve dhe elementëve të tjerë hidromekanikë të lidhur me funksionimin e puseve dhe linjave të daljes së ujit.

Gjithashtu, preventivi përfshin ndërtimin e objekteve civile të lidhura me infrastrukturën e puseve, ku janë parashikuar gjurmime, themele, struktura betonarmeje, hidroizolime dhe ndërtime ndihmëse për funksionimin e sistemit të furnizimit me ujë.

Duke qenë se burimi i furnizimit me ujë për zonën bregdetare të Divjakës mbështetet në shfrytëzimin e ujërave nëntokësore përmes puseve ekzistuese dhe infrastrukturës përkatëse,

realizimi i kontratës kërkon operatorë ekonomikë që disponojnë eksperiencë dhe kapacitete profesionale specifike në fushën e puseve të ujit dhe sistemeve të nxjerrjes së ujit nëntokësor.

b) Çertifikatat që duhet të paraqesin Operatorët Ekonomikë:

- Certifikatë ISO 9001 - 2015 “Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- Certifikatë ISO 14001-2015 “Për Sistemin e menaxhimit të mjedisit”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- Certifikatë ISO 45001-2018 “Për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë”, ose certifikatë me standartin e përditësuar Certifikatë ISO 45001-2023, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- Certifikatën SSH EN ISO 3834-2: 2021, e përditësuar, e vlefshme/ ose ekuivalent

Nëse certifikatat janë në gjuhë të huaj, ato të paraqiten të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën zyrtare shqipe. Këto certifikata të jenë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit ose nga organizmat ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat e mësipërme sipas natyrës së punimeve që do të marrë përsipër të realizojë, referuar kontrates së bashkëpunimit të nënshkruar.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet: “*Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **aftësinë teknike dhe profesionale**;...Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë **se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie*”. Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 përcaktohet: “*Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin **çertifikata** të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë, standartet për shëndetin dhe sigurinë në punë si dhe standartet e menaxhimit të mjedisit. Në bazë të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së punimeve objekt kontrate në mënyrë të qëndrueshme. Referuar natyrës së punimeve që kërkohen të kryhen, njësia e prokurimit ka kërkuar certifikatat e mësipërme për të

vërtetuar se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto punime. Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret si më lart duke qenë në përpjesëtim dhe të lidhura me objektin e kontratës, por edhe sepse ato i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale, organizative, reputacionin e besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Çertifikatë ISO 9001 - 2015 “Per Sistemin e menaxhimit te cilesise”, mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi si dhe mundëson implikimin në menaxhim, identifikimin e riskut dhe mundësive, sigurimin e konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, etj. Kjo kërkesë shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, për të verifikuar dhe garantuar që operatori ekonomik ofertues është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mire të cilësisë.

Çertifikatë ISO 14001-2015 “Per sistemin e menaxhimit te mjedisit” kerkohet pasi angazhimi per mbrojtjen e mjedisit eshte nje kriter madhor ne zgjedhjen e nje prodhuesi, kurse metoda me efikase per te shfaqur kujdes ndaj problemeve lidhur me mjedisin eshte zbatimi i nje sistem menaxhimi per mjedisin konform me parashikimet e standartit nderkombetar ISO 14001. Kërkesa lidhur me çertifikimin ISO 14001:2015 bëhet pasi zbatuesi i punimeve duhet të marrë parasysh një sërë masash për zbutjen e efekteve negative në mjedis, si rezultat i zbatimit të punimeve për përmbushjen e kontrates. Të gjitha punimet e parashikuara në vepër duhen kryer në përputhje me specifikimet dhe dokumentacionin teknik të përgatitur nga projektuesi, duke respektuar legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e mjedisit. Gjithashtu kjo çertifikatë është kërkuar me qëllim vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik *për marrjen e masave të nevojshme mjedisore ndaj dëmtimit të mjedisit kontrolluar duke minimizuar aq sa lejon sistemi*, ku gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis, si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra, ky çertifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

- **Certifikatë ISO 45001-2018** “Për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në pune”, ose certifikatë me standartin e përditësuar **Cerifikatë ISO 45001-2023** mundëson që çdo shoqëri të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, dhe përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve, hetimin e incidenteve etj. Kjo kërkesë është vendosur duke iu referuar natyrës dhe specifikës që mbart objekti i prokurimit që lidhet me procese pune ndërtimi. Rreziqet që lidhen me punën në kantier janë të shumta e për këtë arsye, Autoriteti kontraktor duhet të sigurohet se Operatoret ofertues zotërojnë kapacitetet për menaxhimin, kontrollin dhe parandalimin e risqeve për sigurinë e jetës dhe shëndetit gjatë procesit të punës. Pajisja me këtë lloj certifikate dëshmon se subjekti plotëson kërkesat e paraqitura nga ky standard për identifikimin, kontrollin dhe zvogëlimin e risqeve, të lidhura me shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës. Çertifikatë ISO 45001, është kërkuar me qëllim vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik *në lidhje me vlerësimin e rrezikut dhe përgatitjen e punonjësve duke i ushtruar dhe trajnuar ato me qëllim për të minimizuar/ eliminuar rreziqet të cilat u ekspozohen gjatë kryerjes së punimeve, si një detyrim ligjor*, ku veprimtaria e

ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci shtesë që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

EN-ISO 3834-2:2021/ ekuivalente është standart ndërkombëtar, i cili përcakton kërkesat për sistemin e menaxhimit të cilësisë në Saldim. Çdo Ofertues që merr persiper punime saldimi, duhet të jetë i pajisur me EN-ISO 3834-2:2021 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të jetë në përputhje sistemin e menaxhimit të cilësisë në Saldim. Duke marrë shkas dhe nga natyra e objektit të prokurimit (strukturat metalike ku ka edhe saldime), me ritjen e cilesise se ndertimit, është e domosdoshme që Ofertuesit të jenë të pajisur me EN-ISO 3834-2:2021/ekuivalente pasi materiali i dobët, i pasaktë dhe kushtet negative të saldimit krijojnë probleme serioze, të kushtueshme të cilat mund të cojnë në carje të nyjeve.

c) Në përputhje me kërkesat dhe përmasat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe preventiv, për listën e artikujve, si më poshtë:

- ✓ **Tuba Ujësjiellësi**
- ✓ **Rakorderi**
- ✓ **Mates uji**
- ✓ **Elektropompa**
- ✓ **Pompe Zhytëse**
- ✓ **Sistem Scada**

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, ëebsite, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet në gjuhën zyrtare shqipe ose angleze.
- Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit / ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Shënim: Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme sipas artikujve që do të marrë përsipër të furnizojë referuar preventivit të objektit të prokurimit dhe kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

Shënim: Të gjitha normat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të publikuara nga Autoriteti Kontraktor, do t'i referohen edhe ekuivalenteve të tyre, standarteve shqiptare SSH të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit DPS, në ato raste kur këto standarte janë unifikuar nga kjo Drejtori.

Argumentimi: Paraqitja e ketyre dokumenteve është vlerësuar pasi në objekt kemi të bëjmë me materiale (artikuj) që do të vendosen në vepër, bazuar në dispozitat e sipërcituara dhe referuar nenit 40 pika 6 të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duhet që këto artikuj të plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike e përcaktuara në objektin e kontratës, ku për vërtetimin e përmbushjes së tyre, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: **Autorizim prodhuesi ose distributori, katalogët ose pjesë të tyre**, me qëllim realizimin me sukses të kontratës. Ky objekt, një ndër elementet më të rëndësishëm të tij ka cilësinë e materialeve tubacione të ujësjellësit, matësa etj, që do të vendosen në objekt, cilësinë e zbatimit të punimeve dhe atë të artikujve, në mënyrë që të arrijë qëllimet e tij afatgjata.

Në mbështetje të nenit 77 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 39 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar kërkesën për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit, autorizimit të distributorit të autorizuar nga prodhuesi ose marrëveshjes së bashkëpunimit, si dhe katalogëve teknikë për materialet dhe pajisjet kryesore të sistemit të furnizimit me ujë.

Objekti i prokurimit “Furnizim me Ujë për Zonat Bregdetare të Bashkisë Divjakë dhe Njesisë Administrative Remas” përfshin furnizimin dhe instalimin e pajisjeve kryesore hidraulike, mekanike dhe elektronike, të cilat përbëjnë elementët bazë të funksionimit të sistemit.

Nga analiza bazuar në zërat e preventivit rezulton se janë parashikuar zëra specifikë për: Furnizim dhe vendosje të tubacioneve HDPE dhe elementëve të rrjetit transmetues e shpërndarës; Furnizim dhe montim të rakorderive, adaptorëve, reduktorëve, brylave, nyjeve çmontuese dhe elementëve të tjerë të lidhjes së rrjetit; Furnizim dhe montim të saraçineskave DN300, DN150, DN100 dhe DN50; Furnizim dhe montim të valvulave moskthimi; Furnizim dhe montim të ajruesve; Furnizim dhe montim të matësit elektromagnetik DN250; Furnizim dhe montim të koshit thithës (Suction Strainer DN300); Furnizim dhe montim të pajisjeve të sistemit të pompimit dhe ngritjes së ujit; Furnizim dhe instalim të sistemit të monitorimit dhe kontrollit SCADA; Furnizim dhe instalim të pompave zhytëse dhe elektropompave të sistemit.

Duke qenë se këto pajisje dhe materiale përbëjnë komponentët kryesorë të funksionimit të sistemit të furnizimit me ujë dhe kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetëgjatësinë, sigurinë, performancën hidraulike dhe kostot e mirëmbajtjes së investimit, Autoriteti Kontraktor e konsideron të domosdoshme garantimin e origjinës dhe cilësisë së tyre.

Kërkesa për autorizim të prodhuesit ose marrëveshje bashkëpunimi synon të garantojë se operatori ekonomik ka akses të ligjshëm dhe të drejtpërdrejtë në zinxhirin e furnizimit të produkteve të ofertuara, disponon mbështetje teknike nga prodhuesi dhe siguron furnizimin me produkte origjinale, pjesë këmbimi dhe garanci prodhuesi gjatë zbatimit të kontratës.

Ndërsa kërkesa për paraqitjen e katalogëve teknikë është e nevojshme për t'i mundësuar Autoritetit Kontraktor verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të produkteve të ofertuara me specifikimet teknike të tenderit, duke përfshirë dimensionet, materialet e prodhimit, klasat e presionit, parametrat e funksionimit, standardet e prodhimit dhe certifikimet përkatëse.

Për shkak të rëndësisë që kanë tubacionet, rakorderitë, matësat e ujit, pompat dhe sistemi SCADA në funksionimin e të gjithë investimit, mungesa e dokumentacionit që provon origjinën dhe karakteristikat teknike të tyre do ta bënte të pamundur verifikimin e përputhshmërisë së ofertës me kërkesat teknike të kontratës.

Për sa më sipër, Autoriteti Kontraktor vlerëson se kërkesa për autorizimin e prodhuesit, marrëveshjen e bashkëpunimit dhe katalogët teknikë për tubat e ujës-jellësit, rakorderitë, matësat e ujit, elektropompat, pompat zhytëse dhe sistemin SCADA është e lidhur drejtpërdrejt me zërat konkretë të preventivit, proporcionale me objektin e kontratës dhe e nevojshme për garantimin e cilësisë, origjinës dhe performancës së materialeve dhe pajisjeve që do të instalohen në sistemin e furnizimit me ujë.

Vendosja e kriterit për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit është një kriter i arsyeshëm dhe i domosdoshëm për të siguruar transparencën, cilësinë dhe besueshmërinë në procesin e blerjes së artikujve të sipërcituar. Paraqitja e autorizimit të prodhuesit ose distributorit siguron që operatori ekonomik është kompetent në fushën e caktuar. Ky dokument tregon se operatori ekonomik ka marrë leje zyrtare nga prodhuesi ose distributori për të ofruar mallrat e tyre në treg. Përmes këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor mund të sigurohet që operatorët ekonomikë janë të autorizuar dhe të përshtatshëm për të ofruar këto produkte. Gjithashtu kriteri për paraqitjen e autorizimit siguron një burim të qartë të informacionit në rastin e ndonjë verifikimi të nevojshëm nga ana e Autoritetit Kontraktor. Përmes informacionit të plote të Prodhuesit, Autoriteti ka mundësi të kontaktoje me Prodhuesin për të verifikuar informacionin e ofruar nga operatori ekonomik. Kjo siguron se çdo dyshim i mundshëm mbi autorizimin ose cilësinë e produkteve mund të adresohet me lehtësi dhe pa vonesë. Kriteri për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit nënkupton që operatori ekonomik është përgatitur për të dokumentuar dhe provuar lidhjen midis tyre dhe prodhuesit të mallrave. Ky dokument siguron që operatori ekonomik është i aftë të bëjë bashkëpunim me prodhuesin dhe të sigurojë furnizimin e vazhdueshëm të mallrave. Përmes këtij kriteri, blerësit mund të sigurohen që operatori ekonomik ka arritur një marrëveshje të zyrtarizuar dhe të qëndrueshme me furnizuesin e tyre.

Vendosja e kriterit për **paraqitjen e katalogut ose fragmenteve të katalogut të prodhuesit** është i domosdoshëm për disa arsye të rëndësishme që ndikojnë në cilësinë e procesit të blerjes dhe realizimit të furnizimit të mallrave. Ky kriter ka për qëllim të sigurojë transparencën, cilësinë dhe kujdesin ndaj specifikimeve teknike dhe standardeve të kërkuara. Paraqitja e katalogut ose

fragmenteve të katalogut të prodhuesit jep një informacion të qartë në lidhje me mallrat që do të ofrohen. Ky informacion përfshin të dhëna të detajuara rreth materialeve dhe karakteristikave të mallrave. Kjo siguron që Autoriteti të ketë një pamje të qartë për cilësinë dhe aftësitë e mallrave që ofrohen dhe mund të bëjnë një vlerësim të mirë të ofertave. Kriteri për paraqitjen e fragmenteve të katalogut nënkupton se operatori ekonomik është në gjendje të përmbushë specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara për mallin e planifikuar. Kjo siguron që mallrat e ofruara janë të pajtueshme me kërkesat e tenderit dhe janë të përshtatshme për detyrën specifike. Gjithashtu, bazuar në preventivin e punimeve, ku përveç vendosjes është parashikuar dhe furnizimi i materialeve, referuar natyrës së tyre, ato duhet të jenë të një cilësie të mirë, referuar kostos së tyre dhe funksionit që kanë, me qëllim që të kenë një jetëgjatësi përtej periudhës së garancisë që kanë, vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacionin që vërteton lidhjen me prodhuesin ose distributorin e autorizuar nga do t'i sigurojnë këto materiale objekt kontrate, katalogët e pajisjeve/ materialeve si dhe dokumentacionin me të dhënat e këtyre materialeve, **me qëllim verifikimin/ vlerësimin nga Autoriteti nëse këto materiale/ pajisje për të cilat do të ofertojnë operatorët ekonomikë pjesëmarrës janë në përputhje me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat e tenderit**, si dhe janë të prodhuara nga prodhues të çertifikuar për prodhimin e tyre me cilësi dhe brenda standarteve të miratuara.

Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) përcaktohet se, citojmë: **“1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimin të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.** 2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron punë, furnizime ose shërbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose të tjera, në specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, mund të kërkojë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se punët, shërbimet ose furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, në përputhje me nenin 37, të LPP-së. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe certifikimet përkatëse, si më poshtë:

- a) Operatori Ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë punësuar mesatarisht të paktën **80 (tetedhjetë)** punonjës për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për periudhën e mesiperme në Formularin përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i

pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

- Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mesiperme.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, të paraqitura dhe të konfirmuara nëpërmjet formës elektronike nga organet tatimore për periudhën e mesiperme.

Argumentim: Në mbështetje të nenit 77, pika 1 dhe pika 4 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 39 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar si kriter kualifikimi disponimin e një numri mesatar prej jo më pak se 80 (tetëdhjetë) punonjësish për periudhën e tre muajve të fundit nga data e hapjes së procedurës së prokurimit.

Ky kriter është vendosur në raport të drejtë me natyrën, kompleksitetin, vlerën dhe volumin e punimeve që përfshin objekti “Furnizim me Ujë për Zonat Bregdetare të Bashkisë Divjakë dhe Njesisë Administrative Remas”, i cili parashikon realizimin paralel të një sërë procesesh ndërtimore, hidraulike, mekanike, elektrike dhe teknologjike.

Nga analiza e preventivit për procedurën objekt prokurimi rezulton se kontrata përfshin: Punime të konsiderueshme gjurmimi, transporti dhe mbushjeje për realizimin e rrjetit të ujësjellësit dhe objekteve shoqëruese; Punime shtresash rrugore dhe rikthim të sipërfaqeve të prekura nga gjurmimet; Ndërtimin e objekteve civile, themeleve, pllakave të betonit dhe strukturave betonarme; Punime murature, hidroizolimi, suvatimi, bojatisjeje dhe përfundimi arkitektonik të objekteve teknologjike; Ndërtimin e pusetave, strukturave hidraulike dhe objekteve ndihmëse të sistemit; Furnizimin dhe montimin e tubacioneve të dimensioneve të ndryshme, rakorderive, saraçineskave, valvulave, ajruesve dhe elementëve të tjerë të rrjetit ujësjellës; Instalimin e pompave zhytëse, elektropompave, pajisjeve hidromekanike dhe sistemit SCADA; Punime elektrike, automatizimi dhe vënie në punë të sistemit të furnizimit me ujë.

Gjithashtu, projekti parashikon ndërhyrje në disa zona dhe fronte pune të shpërndara në territorin e Bashkisë Divjakë dhe Njesisë Administrative Remas, çka kërkon organizim paralel të ekipeve të punës për të respektuar afatet e zbatimit të kontratës.

Për realizimin e këtyre proceseve kërkohen njëkohësisht:

Ekipe gjurmimi dhe transporti;
Ekipe për montimin e tubacioneve dhe rakorderive;
Hidraulikë dhe montatorë;
Saldatorë për tubacione PEHD;
Punëtorë ndërtimi për strukturat civile;

Betonues dhe hekurkthyes;
Elektriçistë dhe teknikë automatizimi;
Teknikë për instalimin e pompave dhe pajisjeve hidromekanike;
Personel ndihmës për sistemimin dhe rikthimin e sipërfaqeve.

Për shkak të volumit të konsiderueshëm të punimeve, numrit të madh të zërave të preventivit, shtrirjes territoriale të investimit dhe nevojës për zhvillimin paralel të disa proceseve të ndryshme ndërtimore e teknologjike, Autoriteti Kontraktor vlerëson se disponimi i një numri mesatar prej jo më pak se 80 (tetëdhjetë) punonjësish përbën një kapacitet minimal të nevojshëm organizativ dhe teknik për realizimin e kontratës brenda afateve të përcaktuara.

Gjithashtu, referuar projektit, preventivit, grafikut të punimeve, raportit teknik, specifikimeve teknike, matjeve që ka bërë projektuesi, është vlerësuar ky numër i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomike që nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Ndërsa në lidhje me periudhën e kërkuar, për të paktën 3 muajt e fundit, njësia e prokurimit në hartimin e këtij kriteri iu është referuar datës së publikimit dhe zhvillimit të kësaj procedure prokurimi, ku ka vlerësuar të nevojshme që për vërtetimin e bindjes se operatori ekonomik pjesëmarrës ka një qëndrueshmëri dhe besueshmëri në fuqinë punëtore që realisht disponon, ka kërkuar që ky punësim të disponohet deri në 3 (tre) muaj përpara zhvillimit të procedurës së prokurimit, kërkesë e cila është e arsyeshme, proporcionale dhe aspak diskriminuese.

b) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë të cilët të figurojnë në listëpagesa për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, nga data e hapjes së tenderit, si më poshtë:

• Inxhinier Hidroteknik	1 (një)
• Inxhinier Ndërtimi	1 (një)
• Inxhinier Mjedisi	1 (një)
• Inxhinier Gjeodet / Topograf/ Markshajder	1 (një)
• Inxhinier Mekanik	1 (një)
• Inxhinier Gjeolog	1 (një)
• Inxhinier ndertimi profili transport	1 (një)
• Inxhinier ndertimi profili gjeoteknike	1 (një)

Për secilin pjesëtar të stafit inxhinierik të mësipërm Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, Diplomë, Librezë pune dhe CV (Drejtuesit Teknik të jenë të siguar sipas legjislacionit në fuqi).

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

c) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin tjetër inxhinierik** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)

Për stafin e mësipërm inxhinierik Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, Diplomë, Librezë pune, CV dhe te figuroje ne Listepagesa per te pakten 3 muajt e Fundit.

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

d) Operatori ekonomik pjesëmarrës, në zbatim të Udhëzimit Nr.2 datë 13.05.2005“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, duhet të përcaktojë me anë të një **deklarate** (nënshkruar nga Administratori i Shoqërisë), **Drejtuesin Teknik të punimeve** (inxhinier me eksperiencë) në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërise dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar.

❖ Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit të Vetëdeklarimit sipas Shtojcës Nr.8“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese si më poshtë: Kontratë pune e vlefshme gjate gjithe kohes se zbatimit te punimeve objekt kontrate, Diplomë, Librezë pune dhe CV.

e) Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë të punësuar stafin teknik të përbërë nga punonjës të specializuar dhe të certifikuar sipas profesionit që kryejnë dhe të pasqyruar në listë pagesat e shoqërisë për periudhën 3 muajt e fundit, duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit, me profesione si më poshtë:

- 2 (dy) teknike ndertimi

- 1 (nje) Teknik Mekanik
- 6 (gjashte) hidraulike
- 3 (tre specialiste karpentier
- 2 (dy) montator
- 2 (dy) saldatore
- 2 (dy) hekurkthyes
- 3 (tre) hidroizolues
- 2 (dy) elektrikist
- 2 (dy) murator
- 3 (tre) betonues
- 1 (nje) Specialist IT
- 4 (kater) shofere për drejtim mjetesh të pajisur me leje drejtimi me kategorine "C" dhe/ose "CE" dhe/ose "D" dhe/ose "DE" leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor.

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune të vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, diplomë profesionale / dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike / private të licencuara sipas Ligjit Nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Për specialistët e mësipërm (*me përjashtim të punonjësve shoferë dhe bojaxhi*) të paraqiten kartela personale të sigurimit teknik të vlefshme, të lëshuara nga institucione shtetërore ose nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve.

Shënim: Për shoferët, Operatori Ekonomik pjesëmarrës mund t'i disponojë edhe të kontraktuar me kontratë pune / shërbimi për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri në përfundimin e kontratës.

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese". Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

f) Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të paktën:

- **5 (pese)** Manovratorë / Eskavatoristë / Automakinist, të cilët mund të jenë pjesë e stafit ose të kontraktuar me kontratë pune / shërbimi, për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri në përfundimin e kontratës.

Për secilin pjesëtar të stafit të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune / shërbimi të vlefshme; Dëshmi e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor; Kartela

personale të sigurimit teknik të vlefshme të lëshuara nga institucione shtetërore ose nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve.

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenin 77 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilin parashikohet: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.** Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë **burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, **si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.**” Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 6 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar, parashikohet: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike e profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; **dhe /ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik** të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

Ndërkohë, me qëllim ndërtimin e objektit të veprës sipas projektit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimeve teknike, sigurimit teknik dhe mbrojtjen në punë, duke qenë se vlera e preventivuar për punimet që do të kryhen është mbi 30,000,000 milion në zbatim të Udhëzimit Nr.2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, njësia e prokurimit vlerëson që operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate **Drejtuesin Teknik** të punimeve në objekt, të përfshirë në liçensimin e shoqërisë, si dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Drejtuesi teknik duhet të disponojë kualifikimet e

kërkuara, ku për vërtetimin e tyre, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*.

Kriteri i vendosur për disponimin e numrit minimal prej 80 punonjës, për të paktën 3 muajt e fundit, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-së dhe nenit 39 pika 6/c, ku numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës. Në këtë përlllogaritje njesia e prokurimit ka marrë parasysh numrin e punonjësve që nevojitet për realizimin e objektit dhe afatin e kryerjes së punimeve të përcaktuar në dokumentat e tenderit, periudhën **18 muaj**, dhe në përfundim në zbatim të nenit 77 pika 5 të LPP-së dhe legjislacionit tatimor, janë përcaktuar dokumentat konkrete që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës për përmbushjen e këtyre kushteve.

Ne staf përfshihen punonjësit inxhinierë, specialistë, punonjës të kualifikuar, drejtues të mjeteve të thjeshta apo të rënda etj, duke patur parasysh njëkohesisht volumin e punimeve, grafikun, llojin dhe natyrën e punimeve që do të kryhen si: gërmime, ngjeshje, sistemime, shtrim tubacione, punimet për rrjetin, pusetat, depot, pusin, stacion pompimi, rehabilitim i segmenteve rrugore etj, të cilat duhet të realizohen brenda afatit të parashikuar të objektit, 18 muaj. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet me objektin e kontratës dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. **Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve.** Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllim për të patur rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin rigoroz të punimeve. Referuar natyrës dhe përmasave të kontratës, me qëllim ndërtimin e investimit sipas projektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, dhe vërtetimin e aftësisë organizative, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, referuar zërave (natyrës) të punimeve që do të kryhen objekt kontrate, vlerësojmë se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë stafin e drejtuesve teknik (inxhinierët) me kualifikimet e kërkuara.

Kërkesa specifike për inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë preventivit të punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik), ku citojmë: **Drejtuesi teknik është përgjegjës** për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Referuar natyrës dhe përmasave të kontratës objekt prokurimi, me qëllim ndërtimin e investimit sipas projektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit dhe vërtetimin e aftësisë organizative, përvojën e duhur dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë stafin e drejtuesve teknik (inxhinierët) me kualifikimet e kërkuara. Referuar preventivit dhe projektit të punimeve është e nevojshme prezenca e Inxhinierit të Ndërtimit. Kërkohet për drejtimin teknik të punimeve civile të punimeve ndërtimore, analizimin e projektit, duke garantuar zbatimin korrekt të projektit dhe cilësinë e punimeve. Kërkohet për shkak të punimeve civile të parashikuara në preventiv, të cilat përfshijnë:

gërmime; themele; beton dhe betonarme; mure dhe struktura mbajtëse; godina teknologjike; puseta; rikonstruksione dhe sisteme sipërfaqesh.

Inxhinier Hidroteknik: Referuar preventivit dhe projektit të punimeve është e nevojshme prezenca e Inxhinierit Hidroteknik. Kërkohet për drejtimin teknik të punimeve civile të punimeve Hidroteknike, analizimin e projektit, duke garantuar zbatimin korrekt të projektit dhe cilësinë e punimeve. Kërkohet për shkak se objekti konsiston kryesisht në ndërtimin dhe vënien në funksion të sistemit të furnizimit me ujë, duke përfshirë: rrjetin transmetues dhe shpërndarës; tubacionet HDPE; pusetat e ajrimit, shkarkimit dhe komandimit; saraçineskat, valvulat, matësit elektromagnetikë; sistemin e pompimit dhe transmetimit të ujit.

Inxhinieri hidroteknik është përgjegjës për kontrollin e parametrave hidraulikë, kuotave, presioneve të punës dhe funksionimit të sistemit ujësjellës, duke qenë figura kryesore profesionale e kontratës.

Referuar kërkesës së autoritetit kontraktor për 2 (dy) inxhinier hidroteknik një në licensën e shoqërisë dhe një staf mbështetës argumentojmë se:

Nga analiza e preventivit rezulton se janë parashikuar një numër i konsiderueshëm zërash hidraulikë dhe hidromekanikë, ndër të cilët furnizimi dhe montimi i tubacioneve të dimensioneve të ndryshme, saraçineskave, valvulave moskthimi, ajruesve, nyjeve çmontuese, reduktorëve, matësve elektromagnetikë, pompave dhe pajisjeve të tjera të sistemit të furnizimit me ujë.

Duke marrë në konsideratë shtrirjen territoriale të investimit, volumin e konsiderueshëm të punimeve hidraulike dhe nevojën për zhvillimin paralel të disa proceseve të zbatimit, Autoriteti Kontraktor vlerëson se drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të mbulojë në mënyrë të vetme të gjitha proceset e monitorimit teknik në terren.

Për këtë arsye kërkohet edhe një Inxhinier Hidroteknik si staf mbështetës, i cili do të angazhohet në ndjekjen e punimeve të montimit të rrjetit të ujësjellësit në terren, kontrollin e zbatimit të kuotave dhe parametrave hidraulikë të projektit, verifikimin e montimit të pajisjeve hidraulike dhe hidromekanike, organizimin dhe ndjekjen e provave hidraulike të tubacioneve, koordinimin teknik të proceseve të instalimit të pompave dhe pajisjeve të sistemit, mbështetjen e drejtuesit teknik në kontrollin e cilësisë dhe dokumentacionit teknik të punimeve.

Për sa më sipër, Autoriteti Kontraktor vlerëson se kërkesa për disponimin e 1 (një) Inxhinieri Hidroteknik si staf mbështetës është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës, proporcionale me volumin dhe kompleksitetin e punimeve të parashikuara në preventiv dhe e nevojshme për garantimin e zbatimit cilësor të investimit sipas kërkesave teknike të projektit.

Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder/: Referuar preventivit dhe projektit të punimeve është e nevojshme prezenca e **Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder**. Kërkohet për drejtimin teknik të punimeve civile të punimeve topografike, analizimin e projektit, duke garantuar zbatimin korrekt të projektit dhe cilësinë e punimeve. Kërkohet për shkak të: piketimit të gjurmës

së rrjetit; kontrollit të kuotave të tubacioneve; pozicionimit të pusëve; rilevimeve gjatë dhe pas zbatimit; hartimit të dokumentacionit. Punimet shtrihen në një territor të gjerë dhe kërkojnë kontroll të vazhdueshëm topografik.

Inxhinier Mekanik do të jetë përgjegjës për punimet mekanike ekzistuese në objekt sipas preventivit të punimeve sic janë montimet e pjesëve speciale të celikut, Kërkohet për shkak të instalimit dhe testimit të: pompave zhytëse; elektropompave; valvulave; saraçineskave; nyjeve çmontuese; reduktorëve; pajisjeve hidromekanike të sistemit. Ky inxhinier garanton montimin dhe funksionimin korrekt të pajisjeve mekanike të rrjetit.

Inxhinieri i Ndërtimit profili gjeoteknik: studion vetitë mekanike të tokës dhe përcakton zgjidhjet më të përshtatshme për themelimin dhe shtresat rrugore, në mënyrë që të shmangen deformimet, uljet apo çarjet të tokës gjatë hapjeve të kanaleve për vendosjen e tubave/ linjave të ujësjellësit. Kërkohet për shkak të gërmimeve të thella; ndërtimit të themeleve; strukturave të rezervuarëve; kushteve të veçanta gjeoteknike të zonës bregdetare të Divjakës; kontrollit të stabilitetit të terrenit dhe ngjeshjes së shtresave. Prania e këtij inxhinieri është e nevojshme për të garantuar sigurinë strukturore dhe jetëgjatësinë e veprave.

Ky inxhinier është përgjegjës për zbatimin e testeve gjeoteknike dhe për të përcaktuar përshtatshmërinë e vendit për ndërtim. Testet ofrojnë të dhëna të çmuara mbi vetitë fizike dhe mekanike të dheut, duke përfshirë llojin, fortësinë, densitetin, përshkueshmërinë, porozitetin dhe kompaktimin, ndër të tjera. Kuptimi i këtyre karakteristikave ndihmon inxhinierët të parashikojnë sjelljen e dheut nën kushte të ndryshme ambientale dhe ngarkesa, dhe i mundëson ata të projektojnë themelin e strukturës në mënyrë efektive dhe të sigurt.

Inxhinier Ndërtimi Profili Transport: Referuar preventivit dhe projektit të punimeve është e nevojshme prezenca e Inxhinierit të Ndërtimit. Kërkohet për drejtimin teknik të punimeve civile të punimeve ndërtimore sic janë rruget, analizimin e projektit, duke garantuar zbatimin korrekt të projektit dhe cilësinë e punimeve. Kërkohet pasi preventivi përfshin rikonstrukcion të sipërfaqeve të prekura nga gërmimet shtresa çakëlli, nënshtresa rrugore, trotuare dhe sisteme sipërfaqesh. Pas përfundimit të objektit është shumë e rëndësishme rikthimi i infrastrukturës rrugore sipas standardeve teknike.

Inxhinier Mjedisit: Referuar preventivit dhe projektit të punimeve është e nevojshme prezenca e Inxhinierit të Mjedisit. Kërkohet për drejtimin teknik të punimeve civile të punimeve me natyrë mjedisore, që kanë impakt në ruajtjen e mjedisit duke qenë se janë punime në zona të banuara. Punimet përfshijnë gërmime lineare, transport materialesh, depozitim materialesh të dalës nga gërmimet, rehabilitim sipërfaqesh, mbrojtje të habitateve dhe mjedisit gjatë zbatimit. Prania e inxhinierit të mjedisit garanton respektimin e masave mjedisore dhe kushteve të lejeve mjedisore.

Inxhinier Gjeolog: është kërkuar bazuar në zërat e preventivit të punimeve për procedurën e prokurimit. Inxhinieri i kërkuar është përgjegjës për zërat e gërmimeve lineare përgjatë rrjetit, ndërtimit të rezervuarëve dhe strukturave; karakteristikave gjeologjike të zonës

bregdetare, pranisë së ujërave nëntokësore. Ai monitoron kushtet e terrenit dhe sigurinë e punimeve gjatë gërmimeve dhe ndërtimit.

Janë kërkuar:

Teknik ndërtimi të cilët janë të nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve ndërtimore që do të kryhen. Punëtorët e ndërtimit dhe profesionet e lidhura me to ndërtojnë duke përdorur teknika dhe materiale tradicionale apo moderne të ndërtimit. Kërkohen për ndjekjen e përditshme të proceseve të zbatimit në terren, kontrollin e volumit të punimeve, mbajtjen e dokumentacionit teknik, koordinimin e fronteve të punës dhe verifikimin e zbatimit të punimeve civile, të betonit dhe betonarmesë, puseta, rezervuarëve dhe objekteve teknologjike të parashikuara në preventiv. Konkretisht me zërat; 2.30a – Gërmim dheu themele e plinta; 2.64/1 – Mur me tulla të plota; 2.118 – Kollona b/a monolite; 2.122/1a – Soleta b/a; 2.130/1a – Mure b/a;

Teknik Mekanik është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve Mekanike që do të kryhen referuar Projektit të zbatimit, tekniku mekanik është i domosdoshëm për kontrollin dhe ndjekjen e montimit të pajisjeve mekanike dhe hidromekanike të sistemit, duke përfshirë pompat zhytëse, elektropompat, valvulat, saraçineskat, reduktorët, nyjet çmontuese, matësit elektromagnetikë dhe pajisjet e tjera të rrjetit të furnizimit me ujë. Një Teknik mekanik është i nevojshëm për ndjekjen e montimit të pajisjeve elektromekanike dhe hidromekanike: An-48 – Panel TM 10/20 kV; An-49 – Panel fuqie për pompat shtytëse dhe pompat e puseve; An-1/1 – Pjesë bashkuese inoksi për elektropompa; An-1/2 – Tub fleksibël well Master për pompa;

Hidraulikë të cilët janë të nevojshëm për ndjekjen dhe realizimin e të gjitha punimeve hidraulike, sipas preventivit ku këto punime zënë pjesë të konsiderueshme, si furnizim vendosje tuba dhe rakorderi, punimet për linjen e transmetimit, punimet për puseta, depo, etj. Kërkohen për shkak të volumit të konsiderueshëm të punimeve të montimit të tubacioneve, rakorderive, valvulave, puseta të komandimit, ajrimit dhe shkarkimit, si dhe për realizimin e lidhjeve hidraulike të sistemit të furnizimit me ujë, të cilat përbëjnë pjesën kryesore të kontratës. Konkretisht me zërat e preventivit: An1 – Reduktor me fllanxha DN400/150 PN16; An2 – Manikotë elektrofuzive OD150; An3 – Fllanxhë adaptor DN150; An4 – Tee me fllanxhë e reduktuar; An5 – Ajrues nëntokësor; An41-An49 – Tee elektrofuzioni dhe tapa PEHD të dimensioneve të ndryshme; 2.575 – Puseta kontrolli

Specialistët karpentier janë kërkuar për të kryer punimet e armaturave në beton duke u bazuar në punimet e preventivit F.V hekur betoni si dhe për realizimin e punimeve të armaturës në beton. Janë kërkuar specialistër karpentier për realizimin e kallëpeve të strukturave të betonit dhe betonarmesë të rezervuarëve, puseta, themeleve, bazamenteve të pajisjeve dhe objekteve teknologjike të parashikuara në preventive, konkretisht në zërat: 2.118 – Kollona b/a; 2.122/1a – Soleta b/a; 2.130/1a – Mure b/a; b/a rezervuari C16/20, 334.1 m³.

Është kërkuar **Montator** për problemet mekanike që mund të dalin gjatë zbatimit të punimeve si proceset konstruksioneve të ndryshme metalike. Janë kërkuar specialistët për montimin e elementëve hidromekanikë dhe mekanikë të sistemit të furnizimit me ujë, përfshirë pajisjet e pompimit, valvulat, saraçineskat dhe elementët e tjerë teknologjikë. Konkretisht në zërat e

preventivit; An-48 dhe An-49 – Pajisje elektromekanike; An1-An12 – Reduktorë, fllanxha, tee, ajrues, bërryla.

Gjithashtu janë kërkuar edhe **saldatorë** duke patur parasysh se një pjesë e punimeve është montim tubacionesh , pjesëve lidhëse të tyre (rakorderive), rrethimi i veprave te rendesise se vecante dhe në këtë rast kërkohej personel i kualifikuar. Eshte e nevojshme kërkesa për saldatorë për realizimin e saldimeve të tubacioneve PEHD dhe elementëve metalikë të sistemit, si dhe për garantimin e cilësisë së lidhjeve teknologjike të rrjetit. Konkretisht kërkohen për saldimin e tubacioneve PEHD dhe rakorderive elektrofuzive në zërat: An2, An8 – Manikota elektrofuzive, An41-An49 – Rakorderi elektrofuzioni PEHD

Specialistet **hekurkthyes** janë kërkuar për të realizuar kthimet e hekurit, kornizat e hekurit në armaturat e betonit në strukturat monolite betoni, punime hekur beton etj. Autoriteti kontraktor ka parë të domosdoshmë bazuar në zërat e preventivit kërkesën për hekurkthyes për përgatitjen dhe montimin e armaturave të betonarmesë për themelet, rezervuarët, pusetat, bazamentet dhe strukturat e tjera të betonit të parashikuara në projekt. Konkretisht kërkohen për armaturat e betonarmesë, në zërat 2.166 – Hekur betoni Ø6-10 mm; 2.166/1a – Hekur betoni Ø>12 mm

Specialistet **hidroizolues** janë kërkuar për të realizuar hidroizolimet ne nenobjektet e preventivit te objektit duke permbushur parametrat teknik sipas specifikimeve teknike etj. Bazuar ne zërat e preventivit specialistet hidroizolues duhen për realizimin e punimeve të hidroizolimit të rezervuarëve, pusetave, godinave teknologjike dhe strukturave të tjera që do të jenë në kontakt me ujë ose lagështi të vazhdueshme. Konkretisht kërkohen për punimet e rezervuarëve, pusetave dhe objekteve teknologjike: 2.196/c – Hidroizolim me bazë cemento; 2.195 – Hidroizolim me emulsion dhe bitum, në zërat 2.197 – Hidroizolim me emulsion bitumi dhe katram.

Elektracist duke patur parasysh punime të mirëfillta të natyrës elektrike kryesisht ne stacionet e pompimeve si dhe furnizim vendosje përcjellësa, ndriçues, instalime për ndricim, panele fotovoltaike, Kuadri i fuqise, komandimit dhe i kontrollit te elektropompave, Kuadri i fuqise kryes Kabina elektrike e stacionit të pompimit, për realizimin e instalimeve elektrike të pompave, paneleve elektrike, sistemeve të komandimit, automatizimit dhe integritit të sistemit SCADA të parashikuar në preventiv. Konkretisht kërkohen për sistemin elektrik të stacioneve të pompimit dhe SCADA, në zërat An-01 – Zhvendosje kablli TM 10kV, An-02 – Panel TM 20kV, An-03 – Transformator 400 kVA, An-48, An-49 – Panele fuqie dhe komandimi, 4.131/1.15 – Kabllo fuqie.

Murator duke patur parasysh punime të mirëfillta te ndertimit te mureve per dhoma sherbimi, rrethime, për realizimin e punimeve të muraturës, suvatimit, riparimeve ndërtimore, mbylljes së kanaleve teknologjike dhe përfundimeve arkitektonike të objekteve të projektit etj. Konkretisht kërkohen për zërat 2.64/1 – Mure me tulla, 2.314 – Suvatime, 631-632 – Suvatim në mure betoni.

Betonues duke patur parasysh punime te ndertimit te hedhjes se betonit ne depo, puseta, realizimin e punimeve të betonit dhe betonarmesë që lidhen me themelet, rezervuarët, pusetat, bazamentet e pajisjeve dhe strukturat e tjera civile të objektit etj. Konkretisht kërkohen për realizimin e

strukturave të betonit dhe betonarmesë për zërat Mure b/a rezervuari 334.1 m³, 2.122/1a – Soleta b/a 101 m³, 2.118 – Kollona b/a, 2.130/1a – Mure b/a 225 m³;

Specialist IT është kerkuar bazuar në preventiv të sistemit SCADA, i cili kërkon konfigurim, integrim, programim, testim, monitorim dhe vënie në funksion të pajisjeve të automatizimit dhe kontrollit të sistemit të furnizimit me ujë. Konkretisht kërkohet për instalimin dhe konfigurimin e sistemit SCADA dhe telemetries në zërat An-200 – Konfigurim pajisje informatike RTU dhe transmetim të dhënash, Sistemi SCADA dhe komunikimi i stacioneve të pompimit.

Shoferët: Kërkohen për transportin e tubacioneve, pajisjeve hidromekanike, materialeve të ndërtimit, elementëve prefabrikatë, materialeve të gërmimit dhe makinerive të nevojshme për realizimin e investimit në të gjithë territorin ku shtrihen punimet. Kërkohen për transportin e materialeve dhe pajisjeve të projektit lidhur me zërat 2.37/2a – Transport materialesh ndërtimi dhe dheu, Transporti i tubacioneve, rakorderive, pajisjeve elektromekanike, armaturave dhe materialeve të betonit në të gjitha frontet e punës të projektit etj.

Manovratorë/Eskavatorist/Automakinist: Kërkohen duke marrë në konsideratë shtrirjen e gjerë territoriale të projektit, gjatësinë e konsiderueshme të rrjetit të ujësjellësit, numrin e objekteve teknologjike që do të ndërtohen dhe nevojën për zhvillimin paralel të disa fronteve pune, Autoriteti Kontraktor vlerëson se disponimi i 5 **(pesë) manovratorëve/eskavatoristëve/automakinistëve** përbën kapacitet minimal të nevojshëm për operimin e mjeteve të rënda që do të angazhohen në kontratë.

Numri i kerkuar është proporcional me volumin e punimeve, pasi gjatë zbatimit të kontratës parashikohet përdorimi i njëkohshëm i ekskavatorëve, fadromave, mjeteve transportuese dhe makinerive të tjera të ndërtimit në disa zona pune, me qëllim respektimin e afateve kontraktore dhe garantimin e vijimësisë së proceseve të gërmimit, transportit, mbushjes dhe sistemimit.

Për sa më sipër, Autoriteti Kontraktor vlerëson se kërkesa për 5 **(pesë) manovratorë/eskavatoristë/automakinistë** është e lidhur drejtpërdrejt me zërat konkretë të preventivit, me volumin e punimeve dhe me nevojën për realizimin e kontratës brenda afateve dhe standardeve teknike të kërkuara.

- f) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar si staf mbështetës, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplome (në rast se është inxhinier), dëshmi / certifikatë trajnimi të lëshuara nga subjekte të akredituar sipas ligjit, si dhe të figurojë në listepagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së tenderit, punonjësit si më poshtë:
- 1 (nje) inxhinier duhet te jete i pajisur diplome/Certifikim per vleresimin e materialeve
 - 1 (një) punonjës të certifikuar me dëshmi trajnimi si “Person i ngarkuar përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë” të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, kërkesë kjo në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për

sigurinë në kantier”. Në rastin e bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, sipas nenit 88 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 të ndryshuar, secili prej operatorëve ekonomike duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) “Person të ngarkuar përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë”, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes së bashkëpunimit.

- 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, në mbështetje të pikës 4 të nenit 49 të Ligjit Nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, të pajisur me çertifikatë të lëshuar nga Drejtoria e MZSH.

Shenim: Për specialistin “Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, Operatori Ekonomik mund ta disponojë edhe të kontraktuar me kontratë pune/shërbimi për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri në përfundimin e kontratës.

Për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë Diplomë / Certifikatat e cituara më sipër.

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Agumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312 datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier". Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM Nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si **përgjegjës për ndihmën e parë në rast emergjencash** dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikqyrjes.

Eshtë kërkuar - 1 (një) inxhinier duhet të jete i pajisur diplome/Certifkim për vlerësimin e materialeve, Në mbështetje të nenit 77 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 39 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar si kriter disponimin e **1 (një) inxhinieri të pajisur me diplomë/certifkim për vlerësimin e materialeve**, i cili duhet të jetë pjesë e stafit mbështetës të operatorit ekonomik.

Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me natyrën e objektit “**Furnizim me Ujë për Zonat Bregdetare të Bashkisë Divjakë dhe Njësisë Administrative Remas**”, i cili përfshin furnizimin dhe përdorimin e një sasive të konsiderueshme materialeve dhe pajisjesh ndërtimore, hidraulike, hidromekanike dhe elektromekanike, cilësia e të cilave ndikon drejtpërdrejt në jetëgjatësinë dhe performancën e investimit.Nga analiza e preventivit rezulton se kontrata përfshin ndër të tjera:Tubacione PEHD të dimensioneve të ndryshme për rrjetin transmetues dhe shpërndarës;

Adresa : Lgj.18 Tetori, Rr. Vath Korreshi, pranë ish-parkut të mallrave

E-mail : kontakt@ukl.al ;

[NIPT : M24606401K](mailto:NIPT:M24606401K)

Rakorderi PEHD dhe elektrofuzioni; Saraçineska, valvula moskthimi, ajrues dhe armatura hidraulike; Matësa elektromagnetikë; Pompa zhytëse dhe elektropompa; Beton, betonarme dhe armatura çeliku; Materiale hidroizoluese; Kabllo elektrike, panele elektrike dhe pajisje SCADA; Materiale rrugore dhe materiale për mbushje e ngjeshje.

Konkretisht, në preventiv janë parashikuar zëra si: 2.166 dhe 2.166/1a – armatura çeliku për betonarme; 2.118, 2.122/1a dhe 2.130/1a – struktura betonarmeje; 2.195, 2.196/c dhe 2.197 – materiale hidroizolimi; Zërat An1–An49 që lidhen me rakorderitë, armaturat hidraulike dhe pajisjet e rrjetit; Pajisjet elektromekanike, pompat, panelet elektrike dhe sistemi SCADA.

Për shkak të gamës së gjerë të materialeve dhe pajisjeve që do të përdoren në realizimin e kontratës, Autoriteti Kontraktor vlerëson të nevojshme disponimin e një specialisti të trajnuar për **vlerësimin dhe kontrollin e materialeve**, me qëllim:verifikimin e përputhshmërisë së materialeve me specifikimet teknike; kontrollin e certifikatave të cilësisë dhe deklaratave të performancës; verifikimin e parametrave teknikë të materialeve të dorëzuara në kantier; kontrollin e materialeve të betonit, çelikut, hidroizolimeve dhe materialeve hidraulike; mbështetjen e procesit të kontrollit të cilësisë gjatë zbatimit të kontratës; garantimin që materialet e përdorura janë në përputhje me kërkesat e projektit dhe standardet teknike të zbatueshme.

Duke qenë se kontrata përfshin furnizime dhe instalime me vlerë të konsiderueshme, ku cilësia e materialeve përbën një element thelbësor për sigurinë dhe funksionimin afatgjatë të sistemit të furnizimit me ujë, Autoriteti Kontraktor vlerëson se kërkesa për **1 (një) inxhinier të pajisur me diplomë ose certifikim për vlerësimin e materialeve** është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës, proporcionale me volumin e materialeve të parashikuara në preventiv dhe e nevojshme për garantimin e cilësisë së investimit.

Është kërkuar **Ekspert Zjarrfikës** në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, bazuar në pikën 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe ligjit Nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”. Ky ekspert është i domosdoshëm për të evituar ndodhjen e cdo suate të paparashikuar si dhe mbrojtjen nga zjarri.

Vlerësojme se kjo kërkesë është në përputhje me kontratën objekt prokurimi, pasi stafi operacional i operatorit ekonomik duhet të jetë i trajnuar për çdo rast emergjence, ku ndër to janë edhe rastet e zjarrit, kërkesë kjo bazuar në parashikimet e nenit 38 të Ligjit Nr. 152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, ku përcaktohet se personat fizikë dhe juridikë zbatojnë dispozitat e parashikuara nga ky ligj dhe akte të tjera nënligjore, në lidhje me marrjen e masave për parandalimin e pakësimit të zjarreve, me anë të mjeteve, sistemeve, pajisjeve të diktimit-sinjalizimit për shuarjen e zjarreve, gjatë kryerjes së aktivitetit të tyre.

h) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërisë ose mjek të kontraktuar nga jashtë me kontratë shërbimi / me subjekte të specializuara për këtë qëllim.Mjekët të jenë të pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit që plotëson kriteret e VKM Nr.742

datë 06.11.2003, duhet të plotësojë këtë kërkesë, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes së bashkëpunimit.

Argumentimi: Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 692 datë 13.12.2001 *“Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë” (i ndryshuar me VKM-në nr.742, datë 06.11.2003)*, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë për sigurimin e jetës dhe shëndetit të punëmarrësve nëpërmjet zbatimit të masave të nevojshme, duhet të disponojnë si pjesë të stafit ose të nënshkruajë kontratë shërbimi me një mjek të përgjithshëm.

2.3.4. Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve të ngurta inerte”

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme sipas preventivit të objektit të prokurimit dhe kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

Argumentim: Në mbështetje të nenit 77 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 39 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe legjislacionit në fuqi për menaxhimin e mbetjeve dhe mbrojtjen e mjedisit, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar si kriter disponimin e **Licencës së lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (ish QKL), Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport të mbetjeve të ngurta inerte”**.

Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me natyrën e punimeve që parashikohen në objektin **“Furnizim me Ujë për Zonat Bregdetare të Bashkisë Divjakë dhe Njesisë Administrative Remas”**, ku gjatë procesit të zbatimit do të gjenerohen sasi të konsiderueshme mbetjesh inerte si rezultat i gërmimeve, prishjeve, sistemimeve dhe rikonstruksionit të sipërfaqeve të prekura nga investimi. Nga analiza e preventivit rezulton se kontrata përfshin: Punime gërmimi për hapjen e traseve të tubacioneve; Gërmime për themele, rezervuarë, puseta dhe objekte teknologjike; Transport të materialeve të dala nga gërmimet; Prishje dhe rikonstruksion të shtresave rrugore dhe sipërfaqeve ekzistuese; Punime betoni dhe betonarmeje; Punime sistemimi dhe rikthimi të gjendjes ekzistuese.

Disponimi i kësaj licence garanton që operatori ekonomik ka të drejtën ligjore dhe kapacitetin për: grumbullimin e mbetjeve inerte të gjeneruara gjatë punimeve; transportin e tyre në venddepozitime të autorizuar; respektimin e kërkesave të legjislacionit mjedisor; shmangien e depozitimit të paligjshëm të mbetjeve në territor; mbrojtjen e mjedisit dhe rehabilitimin e zonave të prekura nga punimet.

Për sa më sipër, Autoriteti Kontraktor vlerëson se kërkesa për disponimin e Licencës Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport të mbetjeve të ngurta inerte” është e lidhur drejtpërdrejt me zërat konkretë të preventivit, me volumin e gërmimeve dhe punimeve civile të parashikuara në kontratë, është proporcionale me objektin e prokurimit dhe e nevojshme për garantimin e zbatimit të investimit në përputhje me legjislacionin mjedisor dhe kërkesat e mbrojtjes së mjedisit.

2.3.5. Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.7.B “Për shpues profesionist për ujë”

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme sipas preventivit të objektit të prokurimit dhe kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

Argumentimi: Në mbështetje të nenit 77 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 39 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe legjislacionit sektorial që rregullon veprimtaritë e kërkimit, shpimit, zhvillimit dhe rehabilitimit të puseve të ujit, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar si kriter disponimin e **Licencës së lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), Kodi III.7.B “Shpues profesionist për ujë”**.

Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me objektin e prokurimit **“Furnizim me Ujë për Zonat Bregdetare të Bashkisë Divjakë dhe Njësisë Administrative Remas”**, pasi projekti përfshin ndërhyrje në sistemin e furnizimit me ujë nëpërmjet puseve ekzistuese dhe infrastrukturës së marrjes së ujit, si dhe punime që kërkojnë ekspertizë të specializuar në fushën e puseve të ujit. Nga analiza e preventivit rezulton se janë parashikuar zëra që lidhen drejtpërdrejt me aktivitetin e puseve, konkretisht: **Sonde shpimi pusi (shplarje/pastrim pusi)** – 1 copë, e kërkuar në listën e mjeteve dhe pajisjeve të kontratës; Montimi dhe zëvendësimi i pompave zhytëse; Pajisje hidromekanike dhe elektromekanike të puseve; Tubacione të kolonës së pompimit; Sisteme monitorimi dhe automatizimi të puseve përmes SCADA; Punime të lidhura me stacionet e pompimit dhe objektet e marrjes së ujit.

Gjithashtu, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar :

Inxhinier Gjeolog;

Inxhinier Ndërtimi profili Gjeoteknikë;

Kategorinë e licencës **NS-20 “Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë”**, çka tregon se në kuadër të zbatimit të kontratës parashikohen procese teknike të lidhura me vlerësimin, rehabilitimin, pastrimin, zhvillimin dhe funksionimin e puseve të ujit.

Duke qenë se furnizimi me ujë i zonës mbështetet në burime ujore nëntokësore dhe në infrastrukturën e puseve, ndërhyrjet në këto elemente duhet të realizohen nga operatorë ekonomikë që zotërojnë licencimin specifik profesional për këtë veprimtari, me qëllim: garantimin e sigurisë teknike gjatë punimeve në puse; ruajtjen e parametrave hidrogeologjikë të burimit; shmangien e dëmtimit të kolonës së pusit dhe shtresave ujëmbajtëse; realizimin sipas standardeve të rehabilitimit, pastrimit dhe zhvillimit të puseve; garantimin e funksionimit afatgjatë të sistemit të furnizimit me ujë.

Kërkesa merr rëndësi të veçantë edhe për faktin se investimi zhvillohet në zonën e Divjakës, ku kushtet hidrogeologjike dhe niveli i ujërave nëntokësore kërkojnë trajtim të specializuar teknik dhe profesional.

Për sa më sipër, Autoriteti Kontraktor vlerëson se kërkesa për disponimin e **Licencës Kodi III.7.B “Shpues Profesionist për Ujë”** është e lidhur ngushtë me objektin e kontratës, me zërat konkretë të preventivit që lidhen me pusët, pajisjet e marrjes së ujit dhe stacionet e pompimit, është proporcionale me natyrën e punimeve dhe e nevojshme për garantimin e realizimit të investimit sipas standardeve teknike dhe kërkesave ligjore në fuqi.

2.3.6. Makineri Pajisje

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë makineri dhe pajisje sipas tabelës së mëposhtme, të cilat **duhet të jenë në pronësi të tij ose me qera**, të vërtetuara këto me do

<i>Nr.</i>	<i>Përshkrimi</i>	<i>Sasia</i>
1.	<i>Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes jo me pak se 20 ton</i>	<i>2 (dy cope</i>
2.	<i>Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes 10 - 12 ton</i>	<i>2 (dy) cope</i>
3.	<i>Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes 5 - 10 ton</i>	<i>1 (nje) cope</i>
4.	<i>Kamionçina me kapacitet mbajtes 3.5 - 5 ton</i>	<i>2 (dy) cope</i>
5.	<i>Eskavator me zinxhire</i>	<i>1 (nje)cope</i>
6.	<i>Eskavator me goma</i>	<i>2 (dy)) cope</i>
7.	<i>Fadrome me goma</i>	<i>1 (nje)cope</i>
8.	<i>Minifadrome</i>	<i>1 (nje)cope</i>
9.	<i>Autobetoniere</i>	<i>2 (dy) cope</i>
10.	<i>Autobot Uji</i>	<i>2 (dy)cope</i>
11.	<i>Matrapik</i>	<i>1(nje)cope</i>
12.	<i>Pajisje për matjen e presionit</i>	<i>1 (nje) cope</i>
13.	<i>Sonde shpimi pusi (shplarje pusi)</i>	<i>1 (nje) cope</i>
14.	<i>Gjenerator</i>	<i>2 (dy) cope</i>
15.	<i>Depozita uji</i>	<i>1 (nje) cope</i>
16.	<i>Tokmak</i>	<i>2 (dy) cope</i>
17.	<i>Aparat për saldimin e tubove koke me koke</i>	<i>2 (dy) cope</i>
18.	<i>Sharre prerse Betoni dhe Asfalti</i>	<i>1 (nje) cope</i>
19.	<i>Saldatrice elektrike</i>	<i>1 (nje) cope</i>
20.	<i>Autobitumatriçe</i>	<i>1 (nje) cope</i>
21.	<i>Rimorkiator</i>	<i>1 (nje)) cope</i>
22.	<i>Wellpoint</i>	<i>2 (nje) cope</i>
23.	<i>Aparat per bashkim tubash me elektrofuzion</i>	<i>4 (kater) cope</i>
24.	<i>Rrul ngjeshes</i>	<i>1 (nje) cope</i>

kumentacionin përkatës:

Adresa : Lgj.18 Tetori, Rr. Vath Korreshi, pranë ish-parkut të mallrave

E-mail : kontakt@ukl.al :

[NIPT : M24606401K](#)

Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores për sigurinë në kantier”, si më poshtë vijon:

- Kokore + Jelekë fosforoshentë minimumi 50 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme minimumi 10 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë

❖ Kriteri konsiderohet i përmbushur me *plotësimin e Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8*. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:

Për mjetet që shënohen në rregjistra publikë duhet të paraqitet dokument që vërteton pronësinë e mjetit (certifikatë pronësie), dokument që vërteton rregjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikata e kontrollit teknik SGS si dhe siguracionin e mjetit (policë siguri); të vlefshme.

Për mjetet e siguruara me qera, të paraqiten dokumentet që vërtetojnë rregjistrimin e tij, plus certifikatën e kontrollit teknik (SGS) dhe siguracionin e mjetit të vlefshme. Këto dokumente duhet të shoqërohen me kontratën përkatëse të qerasë të vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Për mjetet e tjera që nuk janë të shënuara në rregjistra publike duhet të paraqitet kontratë noteriale e blerjes / faturë tatimore / dokument zhdoganimi të mjetit.

Për pajisjet në pronësi shoqërohen me akt pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi), të vlefshme.

Për pajisjet me qera të paraqitet kontrata e lidhur para noterit për këtë objekt shoqëruar me akt pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi), të vlefshme.

Shënim: Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të treguara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë deklaratë të nënshkruar nga Administratori, me anë të së cilës të deklarojë vendndodhjen e mjeteve të kërkuara në procedurën e prokurimit publik si dhe të pranojë verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë një deklaratë të nënshkruar nga Administratori, me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruar nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 të ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik¹" në të cilin përcaktohet: *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Në nenin 39 "Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike" pika 6 /d të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 të ndryshuar parashikohet: *"Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon mjetet dhe pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën."*

Këto mjete dhe pajisje referuar preventivit të punimeve janë të nevojshme për realizimin e punimeve, ndaj kerkohet që operatorët ekonomike t'i disponojnë ato pasi nevojiten për kryerjen e punimeve dhe janë në përpjesëtim me objektin e kontratës. Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve /makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, kjo njesi është bazuar tek zerat dhe volumet e preventivit dhe specifikimet teknike të hartuara nga Projektuesi. Mjetet e kërkuara përkohet me proceset ndërtimore sipas zërave të preventivit dhe janë përcaktuar në varesi të volumeve të punimeve dhe kohës së realizimit të veprës.

Dokumentacioni shoqëruar i kërkuar për makineritë, provon çertifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet kontratës së shitjes apo kontratës së qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci autoritetit kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të grafikut të punimeve. Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar, Ligjvënësi i jep të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë nga ana e operatorëve ekonomike dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike. Njësia e prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshme paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit në lidhje me mjetet e pajisjet teknike që operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi.

1. Kamion vetëshkarkues ≥20 ton – 2 copë

Numri prej 2 kamionësh justifikohet nga volumni i madh i materialeve që do të transportohen gjatë zbatimit të kontratës, përfshirë materialet e dala nga gërmimet, agregatet për mbushje dhe materialet për rikonstruksionin e sipërfaqeve. Punimet e gërmimeve dhe transportit zhvillohen paralelisht në disa fronte pune, ndaj një mjet i vetëm nuk garanton ritmin e kërkuar të punimeve.

Lidhet me zerat 2.30/a – Gërmime dheu; 2.37/2a – Transport dheu dhe materialesh.

2. Kamion vetëshkarkues 10–12 ton – 2 copë

Kërkohen për transportin e materialeve ndërtimore, çakëllit, rërës, betonit të gatshëm, tubacioneve dhe materialeve të mbushjes në segmentet e rrjetit. Dy mjete janë të nevojshme për furnizimin paralel të fronteve të punës.

3. Kamion vetëshkarkues 5–10 ton – 1 copë

Kërkohet për segmentet me akses të kufizuar, pranë objekteve teknologjike, pusetave dhe rrugëve dytësore ku nuk mund të operojnë mjetet e tonazhit të lartë.

4. Kamionçina 3.5–5 ton – 2 copë

Numri prej 2 mjeteve lidhet me nevojën për transport të vazhdueshëm të: rakorderive; valvulave; matësve të ujit; pajisjeve elektrike; komponentëve SCADA; veglave dhe materialeve ndihmëse.

Një mjet shërben për furnizimin e rrjetit, ndërsa tjetri për objektet teknologjike dhe stacionet e pompimit.

5. Eskavator me zinxhirë – 1 copë

Kërkohet për gërmimet e thella të rezervuarëve, stacioneve të pompimit dhe objekteve të tjera civile. Volumi i këtyre punimeve justifikon disponimin e përhershëm të një eskavatori të këtij tipi gjatë gjithë kontratës.

Lidhet me gërmimet për rezervuarët, gërmimet për pusetat, gërmimet për stacionet e pompimit.

6. Eskavator me goma – 2 copë

Numri prej 2 eskavatorësh justifikohet nga gjatësia e konsiderueshme e rrjetit ujësjellës dhe nevoja për zhvillimin paralel të gërmimeve në disa segmente. Një eskavator nuk do të ishte i mjaftueshëm për respektimin e afateve të kontratës.

Lidhen me hapjen e kanaleve të tubacioneve, vendosjen e rrjetit transmetues dhe shpërndarës.

7. Fadromë me goma – 1 copë

Kërkohet për ngarkimin e materialeve, sistemimin e terrenit, mbushjen e kanaleve. Volumi i mbushjeve dhe sistemeve e bën të domosdoshme praninë e saj në kantier.

8. Minifadromë – 1 copë

Kërkohet për ndërhyrje në zona të kufizuara, pranë objekteve ekzistuese, pusetave dhe nyjeve të rrjetit ku makineritë e mëdha nuk mund të operojnë.

9. Autobetoniere – 2 copë

Numri prej 2 autobetonieresh justifikohet nga volumi i konsiderueshëm i betonit dhe betonarmesë për rezervuarët, pusetat, bazamentet e pompave, objektet teknologjike.

Punimet e betonit kërkojnë furnizim të pandërprerë për të garantuar cilësinë e hedhjes së betonit.

10. Autobot Uji – 2 copë

Dy autobotë kërkohen për lagjen e shtresave gjatë ngjeshjes, testimin hidraulik të rrjetit, furnizimin me ujë të fronteve të ndryshme të punës.

11. Matrapik – 1 copë

Kërkohet për prishjen e betonit dhe asfaltit në segmentet ku kalon rrjeti ujësjellës.

12. Pajisje për matjen e presionit – 1 copë

Kërkohet për testimin dhe kolaudimin e rrjetit sipas specifikimeve teknike.

13. Sonde shpimi pusi / shplarje pusi – 1 copë

Kërkohet për ndërhyrjet në puset ekzistuese, pastrimin, zhvillimin dhe rehabilitimin e tyre.

Lidhet me kategorinë NS-20, punimet në sistemin e marrjes së ujit.

14. Gjenerator – 2 copë

Dy gjeneratorë justifikohen nga nevoja për furnizim me energji në disa fronte pune dhe për testimin e pajisjeve elektromekanike dhe pompave.

15. Depozitë uji – 1 copë

Kërkohet për testimet teknologjike dhe furnizimin e përkohshëm me ujë gjatë zbatimit të punimeve.

16. Tokmak – 2 copë

Dy tokmakë kërkohen për ngjeshjen e mbushjeve në disa segmente të rrjetit njëkohësisht.

17. Aparat saldimi tubash kokë më kokë – 2 copë

Numri prej 2 aparatesh justifikohet nga volumi i tubacioneve PEHD dhe nevoja për saldime të njëkohshme në disa fronte pune.

18. Sharrë prerëse betoni dhe asfalti – 1 copë

Kërkohet për prerjen e kontrolluar të asfaltit dhe betonit para hapjes së kanaleve.

19. Saldatrice elektrike – 1 copë

Kërkohet për montimin dhe saldimin e elementëve metalikë të sistemit hidromekanik.

20. Autobitumatriçe – 1 copë

Kërkohet për rikthimin e shtresave asfaltike pas mbylljes së kanaleve të rrjetit.

21. Rimorkiator – 1 copë

Kërkohet për transportin e ekskavatorëve, fadromave dhe pajisjeve të rënda ndërmjet fronteve të punës.

22. Wellpoint – 2 copë

Numri prej 2 sistemeve wellpoint justifikohet nga kushtet hidrogeologjike të zonës bregdetare të Divjakës dhe nevoja për uljen e nivelit të ujërave nëntokësore gjatë gërmimeve të rezervuarëve, pusetave dhe traseve të tubacioneve.

Lidhet drejtpërdrejt me gërmimet e thella, punimet në puse, stacionet e pompimit.

23. Aparat për bashkim tubash me elektrofuzion – 4 copë

Numri prej 4 aparatesh justifikohet nga sasia e konsiderueshme e rakorderive elektrofuzive të parashikuara në preventiv dhe nevoja për zhvillimin paralel të punimeve në disa segmente të rrjetit.

Lidhet me manikotat elektrofuzive, tee PEHD, rakorderitë PEHD të rrjetit.

24. Rrul ngjeshës – 1 copë

Kërkohej për ngjeshjen e shtresave të mbushjes, rikonstruksionin e rrugëve, rikthimin e gjendjes ekzistuese pas vendosjes së tubacioneve.

Për shkak të volumit të konsiderueshëm të gërmimeve, mbushjeve, transportit të materialeve, punimeve të betonit, montimit të rrjetit ujësjellës, rehabilitimit të puseve dhe rikonstruksionit të sipërfaqeve rrugore, numri i mjeteve të kërkuara është proporcional me objektin e kontratës dhe garanton realizimin e punimeve brenda afateve kontraktore.

2.3.6. Afati i kryerjes së punimeve

Afati i kryerjes së punimeve është 18 (tetembedhjet) muaj sipas Grafikut të Punimeve të publikuar ne SPE

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve në përputhje me afatin kohor që është lënë në dispozicion për realizimin e kontratës.

Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë deklaratën **ku të shprehet se është dakort me menyren e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të perfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor, (Në rast të shpalljes fitues).**

Në funksion të plotësimit të Shtojcës Nr. 8 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, Operatori Ekonomik ofertues duhet të japë të dhëna të qarta si Emër, Mbiemër, Atësi, Amësi, Datëlindje, Vendlindje, Numër Personal, si dhe kopje të skanuar të dokumentit të identifikimit (shqiptar ose të huaj), për Administratorin / Administratorët e shoqërise, Ortakun / Ortakët e shoqërise, përfaqësues të ndryshëm të posacëm të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë.

Bazuar në parashikimet e Rregullat e Prokurimit Publik, miratuar me VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku në pikën 6 të nenit 26 parashikohet: *Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin;*

Si dhe sipas Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024 neni 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, Pika 5 ku parashikohet: *“Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë:*

- a) *dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit ose entit kontraktor duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre;*
- b) *dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.*

Ofertuesi i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin e parashikuar në pikën 6 të nenit 26 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 të ndryshuar, brenda afatit 5 ditor që ka në dispozicion autoriteti kontraktor, për publikimin e njoftimit të fituesit, sipas nenit 97/1 të LPP-së.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s`kualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike: Bazuar në specifikimet teknike dërguar nga shoqëria projektuese dhe përcjelle për punimet e vepres, duke qenë se specifikimet teknike të përcjella, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të Ligjit Nr.162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenin 40 pika 2 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, njësia e prokurimit po publikon specifikimet teknike.

Njesia e Prokurimit